

1 E enjte, 22 shkurt 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dua t'ju
14 falënderoj të gjithëve që morët pjesë dhe në takim dhe për
15 komentet frytdhënëse. Kemi filluar të analizojmë disa prej
16 parashtrimeve që bëmë dhe edhe shpresojmë që në të ardhmen do
17 kemi disa plane funksionale.

18 Ju lutem, tani sillni dëshmitarin në sallë.

19 Vërej për procesverbal, që z. Krasniqi na ndjek me
20 videolidhje, ndërsa të akuzuarit na ndjekim nga salla e gjyqit
21 dhe Gjykatësi Barthe po ashtu na ndjek përmes videolidhjes në
22 Zoom.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
25 Dëshmitar.

1 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në
3 procesverbal duhet të themi që Dëshmitari W04576 është tashmë
4 në sallën e gjyqit. Më falni, kishit diçka për të thënë z.
5 Misetic? Okej.

6 Dëshmitar, dua t'ju kujtoj edhe një herë t'u përgjigjeni
7 pyetjeve qartë me fjali të shkurtra. Në se nuk e kuptoni një
8 pyetje, lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet ose thjesht
9 thoni që nuk e kuptoni dhe pyetja do të sqarohet për ju.

10 Po ashtu, na thoni ku e bazoni njohurinë për faktet dhe
11 rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

12 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
13 vërtetën sikurse e thatë vetë përmes deklaratës solemne.

14 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
15 se të përgjigjeni si dhe flisni ngadalë në mënyrë që t'ju
16 ndjekin edhe përkthyesit.

17 Nëse në ndonjë moment keni nevojë për pushime, na
18 informoni dhe do të bëjmë organizimet përkatëse.

19 Tani do të vazhdojmë me pyetjet nga z. Misetic.

20 Z. Misetic, fjala është për ju.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

22 DËSHMITARI: HAJRUSH KURTAJ [Vijon]

23 Pyetje të palës tjetër nga Z. Misetic:

24 [Vazhdim]

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

1 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

2 PË. Mirëmëngjesi.

3 PY. Do doja të vazhdonim me një temë të re, tema e re është
4 kjo, si u kyçët ju në UÇK. A është e drejtë që ju u kyçët në
5 UÇK- në qershor të 1998?

6 PË. E saktë.

7 PY. U kyçët vullnetarisht apo ishte ndonjë proces i
8 detyrueshëm?

9 PË. Vullnetarisht.

10 PY. Pra, ishte ushtri vullnetare kur u kyçët ju, kështu?

11 PË. Po, ushtri vullnetare.

12 PY. A folët me ndokënd në UÇK për faktin që donit të
13 kyçeshit?

14 PË. Fillimisht kam fol me vëllaun tim, Xheladin Kurtaj, tani
15 hero i kombit dhe komandantin Agim Bajrami.

16 PY. Pra, në atë kohë bisedove me Agim Bajramin dhe Agim
17 Bajrami ndërkohë ishte komandant i brigadës, kështu?

18 PË. Komandant i njësiveve të para në Kaçanik.

19 PY. Pra, ju nuk kishit ndonjë dijeni personalisht sesi u bë
20 Agim Bajrami komandant, kështu?

21 PË. Jo.

22 PY. Ju u kyçët si ushtar i thjesht përpos faktit që ju kishit
23 edukim ushtarak, kështu?

24 PË. E saktë.

25 PY. Dhe si ushtar i thjesht, kush t'i jepte ty detyrat?

1 PË. Komandanti Agim Bajrami.

2 PY. Sa i takon strukturës së UÇK-së në Nerodimë. Ju nuk e
3 dini personalisht sesi ka qenë struktura në zonën e Nerodimës
4 përpara qershorit të 1998, kështu?

5 PË. E saktë.

6 PY. As nuk e dini vetë personalisht sesi u bë Shukri Buja
7 komandant i zonës?

8 PË. Nuk e di.

9 PY. Ka ndonjë informacion në librin tuaj sesi u bë Shukri
10 Buja apo Agim Bajrami komandant dhe nëse janë këto
11 informacione, këto informacione janë informacione që keni
12 mësuar më pas, kështu?

13 PË. Të gjithë ato informacione i kam mësuar pas, kryesisht
14 pas luftës. Edhe pse në libër e kam thënë disa herë se i kam
15 zmadhu gjërat, i kam zbukuru gjërat.

16 PY. Në rregull. Nga qershori - gushti i 1998, është e vërtetë
17 që ju ishit një ushtar i thjesht në UÇK?

18 PË. E vërtetë.

19 PY. Do të doja të diskutonim për një çast emërimin e Agim
20 Bajramit, i cili përmendet në librin tuaj dhe për këtë ju
21 pyeti edhe Prokuroria dhe kjo është reflektuar në transkriptin
22 e ditës së djeshme. Prokurori ju lexoi një paragraf të librit
23 tuaj ku thoni:

24 "Me urdhër të Shtabi Përgjithshëm të UÇK-së, Shukri Nuja
25 u rikthye në Kaçanik dhe shpalli vendimin e Shtabit të

1 Përgjithshëm për të emëruar Agim Bajramin si komandant të
2 njësimit të Kaçanikut”.

3 Ju kujtohet që ju bëri pyetje Prokurori për këtë dje?

4 PË. Po, më kujtohet. Vetëm, prapë e përsërisë, asnjëherë nuk
5 kam pa urdhër dhe as nuk kam pas takime me Shukri Bujën për
6 atë rast.

7 PY. Në rregull. Që të kuptojmë faktet, ju as nuk keni qenë në
8 UÇK në kohën kur u bë Agim Bajrami komandant i zonës së
9 Kaçanikut, kështu?

10 PË. E vërtetë.

11 PY. Në rregull. Pra, çdo gjë që keni mësuar lidhur me
12 emërimin e Agim Bajramit e keni mësuar përmes informatave që
13 keni mbledhur pas lufte, kështu?

14 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Pyetja është bërë disa
15 herë dhe ka marrë përgjigje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe një herë
17 mund ta bëni pyetjen, Misetic.

18 Përgjigjuni, Dëshmitar.

19 DËSHMITARI: Ju lutem edhe një herë pyetjen.

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Pra, çdo gjë që keni mësuar lidhur me emërimin e Agim
22 Bajramit e keni mësuar pas lufte, kështu?

23 PË. Pas lufte.

24 PY. Në rregull. Do doja ta keni parasysh këtë pikën që
25 diskutuam për Agim Bajramin që pretendohet që është emëruar me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 6

1 urdhëresë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së sepse do ju bëj
2 pyetje për këtë.

3 Ju gjatë luftës nuk kishit ndonjë dijeni për vendime të
4 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, kështu?

5 PË. E saktë.

6 PY. Më 5 gusht të 1998, u bëtë zëvendëskomandant për
7 stërvitje dhe operacionet e Brigadës 162, kështu?

8 PË. E vërtet.

9 PY. Kush ju emëroi ju si zëvendëskomandant?

10 PË. Agim Bajrami.

11 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Dhe ju ishit zëvendëskomandant i Brigadës 162 kur u bë
14 dhe Qamil Ilazi komandant i brigadës më 10 gusht, pas vdekjes
15 së Agim Bajramit, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe ju e mbajtët këtë pozitë, pra, pozitën e
18 zëvendëskomandantit deri në maj të 1999, kështu?

19 PË. E saktë.

20 PY. A keni marrë ndonjëherë pjesë të shtabeve të zonës në
21 ndonjë moment nga qershori i 1998 deri në maj të 1999, pra,
22 takime të shtabit të zonës?

23 PË. Nuk kam marrë pjesë se nuk ka qenë edhe kompetencë e
24 imja.

25 PY. Ju na thatë se u bëtë komandant në detyrë i Brigadës 162

1 në 14 maj të 1999, pas vrasjes së Qamil Ilazit, kështu?

2 PË. Kam vazhdu me kry detyrën e komandantit tuj e pas
3 parasysh se kam qenë zëvendëskomandant i brigadës.

4 PY. Po. Do doja të flisnim për një çast ose të na sqaroni,
5 çfarë marrëdhënie kishte Agim Çeku, çfarë lidhje kishte Agim
6 Çeku me detyrat tuaja si komandant i brigadës. E thënë
7 ndryshe, Agim çeku ju thirri në telefon?

8 PË. Ditën që është varros komandant Bardhi, kemi komunikuar
9 me telefon dhe e kam njoftuar se është bë varrimi i komandant
10 Bardhir, komandant Qamil Ilazi.

11 PY. Në rregull. Po a u bë ndonjë diskutim se kush do ta
12 zëvendësonte z. Ilazi në rolin komandues?

13 PË. Nuk ka pas diçka të specifikume. Vetëm se ka thënë se
14 duhet ta vazhdojmë luftën deri në fund.

15 PY. Mirë. Agim Çeku a ju tha se po fliste në emër të Shtabit
16 të Përgjithshëm apo po fliste për llogari të vet?

17 PË. Nuk më kujtohet për shkak se kohë lufte dhe nuk kemi
18 lëshu në kësi analiza.

19 PY. Pra, tani ku jeni në sallën e gjyqit, ju thoni që unë nuk
20 e di nëse Agim Çeku ka thënë ndonjëherë a fliste për llogari
21 të vet apo fliste për llogari të Shtabit të Përgjithshëm, këtë
22 po na thoni këtu në bankën e dëshmitarit?

23 PË. Nuk më kujtohet kjo.

24 PY. Do të doja, nëse nuk ju kujtohet, do përpiqem t'ju
25 ndihmoj me kujtesën e të shohim nëse mund të komentoni diçka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdim)

Faqe 8

1 më shumë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja t'ju tregoj
3 intervistën që keni dhënë për ZPS-në, e cila mban numrin
4 074301-TR-ET Pjesa 1, faqja 26, rreshtat 2 deri në 8. Ndërsa
5 në shqip 0740301-TR-AT Pjesa 1, faqja 31, rreshtat 10 deri në
6 19.

7 PY. Ta sqarojmë këtë gjë, ZPS-ja ju ka thënë -- e presim sa
8 të dali dhe shqipja.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Janë të dyja në anglisht.

10 PY. Dëshmitar, fillojmë tek rreshti 10 në shqip, mund ta
11 ndiqni. Thuhet:

12 "Në atë thirrje, çfarë ju tha ai, domethënë, ishte urdhër
13 që e lëshonte ai apo urdhri ishte lëshu nga Shtabi i
14 Përgjithshëm?

15 "PË. Me siguri urdhri, po ai ishte shefi i Shtabi
16 Përgjithshëm. Nuk e kam pyet unë në detale se në çfarë
17 cilësie, po ka qenë shefi i Shtabi Përgjithshëm".

18 "PY. Pra, duke marrë parasysh pozicionin që kishte ai ju
19 e morët që ishte urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm?

20 "PË. Po".

21 Dëshmitar, ju ndihmon kjo me kujtesën lidhur me bisedën
22 që keni pasur me z. Çeku?

23 PË. Thjesht nuk më kujtohet që ka qenë ndonjë urdhër i
24 veçantë.

25 PY. Faleminderit.

- 1 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin.
- 2 PY. Dëshmitar, pas vdekjes së Agim Bajramit, kush e emëroi
- 3 Qamil Ilazin si komandant, e dini këtë?
- 4 PË. Nuk kam njohuri dhe nuk kam pa asnjë dokument.
- 5 PY. Në rregull. Unë po ju them dhe kjo është e marrë nga
- 6 dosja paragjyqësore e ZPS-së në paragrafin 249, 520, ZPS-ja
- 7 pretendon se Qamil Ilazi është emëruar nga Shukri Buja si
- 8 komandant brigade. E kuptuat këtë?
- 9 PË. E kuptoj. Po unë kam pas njohuri.
- 10 PY. Në rregull. Keni ndonjë ide pse do ta emëronte Agim
- 11 Bajramin si komandant Shtabi i Përgjithshëm, por tre muaj më
- 12 vonë, Qamil Ilazin e emëroka Shukri Buja?
- 13 PË. Nuk kam posedu me këto informata asnjëherë.
- 14 PY. A është e vërtet që kur u bëtë komandant brigade në maj
- 15 të 1999 që ju kujtohet që keni marrë vetëm një urdhëresë prej
- 16 Shukri Bujës?
- 17 PË. Gjatë luftës nuk kam marrë asnjë urdhëresë.
- 18 PY. Dje të treguan një dokument.
- 19 Z. MISETIC: [Përkthim] Ja do ta gjej nga referencat. Ju
- 20 lutem të shohim provën materiale P01014, është pjesë e librit
- 21 tuaj "Flakë e Pashuar". Do të doja që të shfaqej në ekran
- 22 faqja 044181.
- 23 PY. Dëshmitar, ju kujtohet që ju bënë pyetje lidhur me këtë
- 24 urdhëresë?
- 25 PË. Po, më kujtohet.

1 PY. Më korrigjo nëse e kam gabim, ju keni thënë se e morët po
2 nuk u zbatua asnjëherë, kështu?

3 PË. E kam thënë se kjo urdhëresë më 27 maj është lëshu. Kurse
4 në Kaçanik lufta ka përfunduar më 11 qershor dhe deri në
5 përfundim të luftës kjo urdhëresë nuk ka mbërritur në komandën e
6 brigadës. Dhe vetëm pas lufte e kam parë.

7 PY. Që të jemi të qartë. Kur thoni "pas lufte" e keni fjalën
8 menjëherë pas luftës në qershor të 1999 apo kohë më pas?

9 PË. Kohë më pas, për shkak se nga 12 qershori më nuk kam qenë
10 në brigadë dhe nuk njohuri rreth, nuk kam pasë mundësi dhe t'i
11 shoh dokumentacionin.

12 PY. Ku e keni parë këtë dokument më pas?

13 PË. Këtë dokument e kam pa pastaj në Komandën e Zonës 6 të
14 Trupave Mbrojtëse të Kosovës, ku kam qenë shef shtabit në atë
15 komandë.

16 PY. Bëhet fjalë për atë arkivën që folëm dje?

17 PË. Në administratën e Komandës së Zonës 6, po.

18 PY. Administrata e Zonës 6 është vendi ku gjetët dokumentet e
19 arkivuara të UÇK-së për të cilët diskutuam dje?

20 PË. Një pjesë të këtyre dokumenteve që edhe i kam prezantuar.

21 PY. A e keni idenë ku janë tani këto dokumente, ku gjenden?

22 PË. Nuk kam informata për shkak se me vendimin që është
23 marrë, me vendimin ndërkombëtar që është marrë, nuk është bë
24 transformimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës në Forcën e
25 Sigurisë, por është bë shpërbërja e Trupave Mbrojtëse të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdim)

Faqe 11

1 Kosovës dhe fare nuk kam njohuri ku ekzistojnë ato dokumente.

2 PY. Mirë. Do t'ju bëj dhe një pyetje tjetër lidhur me këtë
3 temë për arkivën.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Por do kërkoja që të shfaqej në
5 ekran prova materiale P01015, që është libri juaj, më falni,
6 është faqe që nuk është pranuar, kështu që do më duhet të
7 përdorë numrin që është pranuar, 036622 në faqen 036636.

8 Ndërsa në shqip është 077053. Shkojmë më poshtë, paragrafi
9 drejt fundit tek anglishtja. Paragrafi i tretë nga fundi në
10 shqip.

11 PY. Dëshmitar, ju thoni kështu:

12 "Në përgatitjen e këtij punimi jam mbështetur në
13 materiale të shumta autentike, shkresa, urdhëresa, raporte dhe
14 analiza të cilat janë të pasistemuara në arkivin e zonës
15 operative të Nerodimës, Zonës 6, Trupave Mbrojtëse të Kosovës,
16 pastaj në arkivin e Kosovës, sektorin e UÇK-së".

17 Unë isha i interesuar lidhur me këtë që keni thënë ju
18 arkiva është e pasisteluar. Çfarë keni dash të thoni ju me
19 këtë?

20 PË. Me këtë kam dash të them se vetëm në arkivin në komandën
21 e Zonës 6, Trupat Mbrojtëse i kanë pa disa dokumente e jo më
22 shumë. Edhe këtë fjali e kam zmadhu, e kam zbukuru për libër,
23 ashtu siç e kam prezantuar edhe në sesionet e mëparshme.

24 PY. Por a është e vërtetë që arkivat ishin të pasistemuara
25 kur shkuat ju atje për të kërkuar dokumente?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 12

1 PË. Po vetëm në komandën e Zonës 6 të Trupave Mbrojtëse të
2 Kosovës kam pas qasje. Dikund tjetër nuk kam pas dhe nuk e di.

3 PY. Arkiva e Zonës 6 ishte e pasistemuar?

4 PË. Nuk më kujtohet, po me siguri ka qenë e pasistemuar se sa
5 ka përfunduar lufta. Sa janë formu Trupat Mbrojtëse të
6 Kosovës, me siguri në atë kohë ka qenë a pasistemume.

7 PY. Kur thoni ju "e pasistemuar" e keni fjalën që dokumentet
8 që ishin nuk ishin sipas radhës? Ishin nëpër kuti? Mund të na
9 e shpjegoni kur thoni e pasistemuar? Çfarë, si ishin këto
10 dokumente?

11 Jo. Po e tërheq pyetjen. Si ishte dhoma ku ishin këto
12 dokumente?

13 PË. Po me siguri kanë qenë -- nuk kanë qenë të sistemuara
14 sipas radhës sa më kujtohet. Ma shumë nuk di.

15 PY. Mirë. Referencat që keni bërë për urdhëresat nga Shtabin
16 e Përgjithshëm në librin tuaj nuk janë të bazuara në njohuritë
17 tuaja personale, ju s'keni njohuri personale lidhur me këto
18 urdhëresa, apo jo?

19 PË. Jo, nuk kam.

20 PY. Prokurori ju bëri disa pyetje për Bislim Zyrapin.

21 Asnjëherë nuk keni bisedu me Bislim Zyrapin gjatë luftës,
22 kështu?

23 PË. Asnjëherë nuk kam biseduar.

24 PY. A keni parë ndonjëherë ndonjë urdhëresë nga Bislim Zyrapi
25 gjatë konfliktit?

1 PË. Pas luftës i kam parë ato që i kemi diskutu në sesionet e
2 kalume.

3 PY. Por gjatë kohës që ishit zëvendëskomandant apo komandant
4 në detyrë, a keni parë ndonjëherë me sytë tuaj ndonjë
5 urdhëresë prej Bislime Zyrapit?

6 PË. Jo.

7 PY. A keni komunikuar në ndonjë formë të mundshme me Bislime
8 Zyrapin gjatë kohës që ishit zëvendëskomandant apo komandant
9 në detyrë?

10 PË. Jo.

11 PY. A keni komunikuar me ndokënd tjetër në Shtabin e
12 Përgjithshëm nga qershori i 1998 deri në qershor të 1999, me
13 përjashtim të kësaj telefonatës që keni pasur me Agim Çekun?

14 PË. Me askënd tjetër.

15 PY. Ju bënë disa pyetje për referencat që keni bërë në zonën
16 tuaj lidhur me "vendimet operative që merreshin nga Shtabi i
17 Përgjithshëm i UÇK-së". Bazuar në përgjigjen tuaj, i takon që
18 deklaratat që keni bërë nuk është se janë deklarata të
19 mbështetura në dijeni personale që keni pasur ju?

20 PË. E saktë.

21 PY. Të flasim shkurtimisht së bashku për organizimin e UÇK-
22 së.

23 Juve kishit përvojë ushtarake nga shërbimi në ushtrinë
24 jugosllave. Kur keni hyrë në UÇK në qershor të 1999, a gjetët
25 aty, pra, a konstatuat se kishte aftësi ushtarake për të

1 funksionuar si ushtri e vërtet?

2 PË. Shumë pak për me thënë mos me thënë hiç, për shkak se
3 pjesa dërrmuese ishin rinia që nuk kishin njohuri ushtarake.

4 PY. Po sa u takon armëve? UÇK-ja kishte armë të mjaftueshme,
5 armatim të mjaftueshëm në vitin 1998?

6 PË. Jo, shumë pak. Dhe furnizimi ka qenë shumë i vështirë.

7 PY. Ju a kishit dijeni për ndonjë përpjekje që bëhej për të
8 koordinuar fizikisht me njësite të ndryshme të UÇK-së?

9 PË. Jo, në atë kohë për shkak se kam pasë detyra që t'i
10 përgatis ushtarët në përdorimin e armëve, t'i përgatis për
11 vijën e frontit. Kështu që nuk kam pas kohë unë të mirrëna me
12 koordinime të tjera.

13 PY. Po ata të cilët dezertuan UÇK-në pas ofensivave të verës?

14 Pra, kishte njerëz të tillë të cilët thjesht ikën nga UÇK-ja?

15 PË. Te na nuk njihet termi dezertor. Ka qenë ushtri
16 vullnetare. Ka ardhun, ka shërby sa ka mund. Në momentin që
17 është lodhë është ndalë, ka pushu. Në momentin që ka dash me
18 vizitu familjen nuk -- termi dezertor ka qenë i panjohur në
19 ushtrinë tonë.

20 PY. Po dikush i cili sapo ishte larguar nga UÇK-ja, keni ju
21 dijeni për ndonjë rast kur mund të jenë disiplinuar këta?

22 PË. Nuk kam njohuri.

23 PY. Si zëvendëskomandant i brigadës, keni njohuri për rastin
24 në brigadën tuaj ku ushtarët janë larguar prej brigadës?

25 PË. Nuk kemi pas kësi raste.

1 PY. Askush nga brigada s'është larguar asnjëherë pas
2 ofensivës së verës?

3 PË. Edhe nëse janë largu janë kthy edhe kanë vazhdu pa asnjë
4 problem. Pasi i kanë vizitu familjet janë kthy prapë në luftë
5 dhe kanë vazhdu luftën.

6 PY. Ka pasur diskutime ndonjëherë për nevojën për të marrë
7 masa disiplinore kundër njerëzve të cilët mund të jenë larguar
8 pa leje?

9 PË. Nuk ka pas kësi raste.

10 PY. Dëshmitar, t'ju bëj tani disa pyetje për komunikatat.

11 Keni dijeni se kush i hartonte deklaratat politike dhe
12 komunikatat në emër të UÇK-së?

13 PË. Nuk kam pas dijeni për këto komunikata asnjëherë.

14 PY. Nga kjo e kuptoj se nuk keni marrë asnjëherë asnjë
15 komunikatë apo deklaratë politike?

16 PË. Asnjëherë nuk kam pranë asnjë komunikatë, asnjë deklaratë
17 politike.

18 PY. Keni lexuar ndonjëherë ndonjë komunikatë apo deklaratë
19 politike nëpër gazeta nga qershori 1998 deri në qershor të
20 1999?

21 PË. Në atë kohë nuk kemi pas mundësi se nuk e kemi pas asnjë
22 gazetë tonën. Se kemi qenë të okupum në të gjitha segmentet,
23 në të gjitha fushat.

24 PY. A ju ka tregu kush për ndonjë porosi, mesazh që mund të
25 kenë marrë përmes një deklarate politike apo ndonjë

1 komunikate?

2 PË. Nuk kemi pas kësi biseda.

3 PY. Ju është dhënë ndonjëherë mundësia që t'i shihni këto
4 deklarata politike e komunikata pas lufte?

5 PË. Pas lufte ka pas përmes shtypit, përmes mjeteve të
6 informimit po nuk, thjesht, nuk jam marr me to dhe nuk kam
7 njohuri të veçanta rreth tyre.

8 PY. Kishit dijeni për ndonjë udhëzim apo politikë të UÇK-së
9 sesi t'i trajtonit kolaboracionistët?

10 PË. Asnjë dijeni në këtë drejtim nuk kam pas asnjëherë.

11 PY. Shukri Buja a të ka përcjellë ndonjëherë, a ka dhënë,
12 domethënë, ndonjë udhëzim apo rregullore apo politika sesi
13 trajtohen kolaboracionistët?

14 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Nga përgjigja e
15 mëparshme dëshmitari tha se nuk ka asnjë dijeni për një
16 çështje të tillë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
18 kundërshtimi.

19 Mund t'i përgjigjeni pyetjes.

20 DËSHMITARI: Nuk kam pas komunikim me Shukri Bujën. Se unë
21 edhe thashë komunikimin nëse e ka pas e ka pas komandanti, jo
22 unë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Agim Bajrami apo Qamil Ilazi a të ka dhënë ndonjëherë
25 ndonjë rregullore apo politikë sesi t'i trajtonit

1 kolaboracionistët?

2 PË. Jo, asnjëherë. Edhe nuk e kemi pas në këtë punë, nuk kemi
3 pasur kohë me u marrë me këto se kemi pasun punë në drejtim të
4 përgatitjes së njësive dhe çlirimit, mbrojtjes së vendit.

5 PY. Aso kohe e kuptonit se çfarë ishte kolaboracionisti?

6 PË. As jam marrë me atë punë. Asnjëherë nuk më ka shku mendja
7 të mendoj në atë drejtim. Kam njoft vetëm forcat çlirimtare
8 edhe forcat okupatore.

9 PY. Ta përdor ndryshe atëherë, të them një fjalë tjetër. A
10 ishit ju në dijeni për persona në zonën e Nerodimës të cilët
11 nuk e mbështetnin UÇK-në?

12 PË. Nuk kam qenë në dijeni.

13 PY. Ju kishit të bënit me LDK-në, kishit marrëdhënie me LDK-
14 në Nerodimë. LDK-në e konsideronit gjë si kundërshtarë të
15 UÇK-së?

16 PË. Asnjëherë nuk e kam konsideru si kundërshtarë.

17 PY. Dinit gjë ndonjëherë nëse persona të tjerë të UÇK-së,
18 pra, që ishin anëtarë të UÇK-së në zonën e Nerodimës e
19 konsideronin LDK-në mbase si kundërshtarë të UÇK-së?

20 PË. Nuk kam njohuri të tilla.

21 PY. Nëse një shqiptar martohej me një person të kombësisë
22 serbe, a konsiderohej ky njeri si kundërshtar i UÇK-së?

23 PË. Jo.

24 PY. Nëse dikush shoqërohej me serbë apo me romë gjatë
25 konfliktit në zonën e Nerodimës, flas për zonën e Nerodimës që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 18

1 të diskutojmë për ato gjëra që mund të dini, pra, këta a do të
2 konsideroheshin mbase kundërshtarë të UÇK-së?

3 PË. Jo. Edhe pse unë kompetencë e imja nuk është për zonën.
4 Mund të flas vetëm për pjesët e Kaçanikut ku kam vepru vetë.

5 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar i Trupit Gjykues, nuk
7 kam më pyetje tjera.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] S'kam pyetje.

10 Z. TULLY: [Përkthim] Një moment sa të rregulloj orenditë
11 në tryezë.

12 Pyetje të palës tjetër nga Z. Tully:

13 Z. TULLY: [Përkthim

14 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

15 PY. Mirëdita.

16 PY. Më quajnë Eric Tully, përfaqësoj Rexhep Selimin. Kam nja
17 30 minuta pyetje për ju. Të gjitha pyetjet që i kam kanë të
18 bëjnë me librin tuaj. E di se ju keni shkruar më shumë se një
19 libër, e kam fjalën vetëm për librin "Lufta e UÇK-së në
20 Nerodimë" dhe kur them "libri" është ky libër.

21 Kam tre pjesë, i kam ndarë pyetjet në tre pjesë, do të
22 flasim për fjalët e përdorura në libër, procesin që keni
23 përdorur për intervistat dhe shënimet në fund të faqes.

24 Dje, ZPS-ja foli për parathënien që e ka shkruajtur z.
25 Selim Daci dhe ju lexuan një citim nga libri dhe aty në libër

1 shkruhet:

2 "Autori ka përdorur si burime dhe e ka mbështetur këtë
3 monografi në shumë dokumente autentike, urdhëresa, raporte dhe
4 studime të cilat mbeten të pakatologuara ... në Zonën
5 Operative të Nerodimës, pra, në komandën e Zonës VI në këtë
6 rast ..."

7 Dhe pastaj ai e ka vazhduar punën prej këtu.

8 Unë do t'ju flasim për këtë, po ai, pikë së pari, a ju
9 kujtohet që ju kanë bërë pyetje për këtë pjesë libri dhe?
10 PË. Po.

11 PY. Ju u përgjigjët pyetjes së Prokurorit në se Dr. Daci e
12 kishte të drejtë apo jo është se ai e ka mbështetur këtë pjesë
13 të finales së vet në bazë të asaj që ka parë në libër.

14 Pikë së pari, ju e keni kontaktuar z. Daci që ta shkruaj
15 këtë parathënie për librin. Kështu është?

16 PË. E saktë.

17 PY. Nga hyrja që ju vetë keni shkruar për librin vërej se ju
18 keni përmendur një falënderim për sugjerimet dhe kritikën që
19 Shukri Buja dhe Dr. Daci ju kanë bërë për librin, por nuk i
20 falënderoni për parathënien. Pra, me sa kuptoj unë ju e keni
21 shkruar një herë librin, ia keni dhënë Dr. Dacit dhe ai pastaj
22 e ka shkruar parathënien dhe është futur në libër mbasi ia
23 keni dhënë dorëshkrimin atij, kështu?

24 PË. E saktë.

25 PY. Dhe e kam kuptuar saktë nga përgjigjet tuaja nëpër

1 pyetjet e ZPS-së si në intervistë edhe dje që, në fakt, nuk
2 është se askush t'ju ketë bërë ndonjë kritikë, të themi, për
3 përmbajtjen e librit, përfshirë këtu dhe z. Daci, apo jo? Pra,
4 nuk është se ka pasur kritika për gabime të bëra?

5 PY. Deri në këtë moment së paku nuk jam në dijeni për
6 kritikën edhe mund të ketë qenë ndonjë kritikë me shkrim. Po
7 nuk kam njohuri.

8 PY. Nga intervista me ZPS-në, në fakt, ju e keni kategorizuar
9 parathënien e z. Daci si një zmadhim në mënyrë që të pëlqehet
10 më mirë autori, pra, të shitet më mirë në treg të themi. Kjo
11 është nga Pjesa 1. Pra, ishte si një lloj procesi marketingu
12 le të themi për të përfshirë këtë parathënie të tij për
13 librin?

14 PË. Saktë është. Më shumë se marketing.

15 PY. Po ju bënte një nder duke përfshirë dhe këtë parathënie?

16 PË. Nuk po e kuptoj pyetjen.

17 PY. Domethënë, po ju jepte diçka të mirë. Si të thuash, po ju
18 bënte një farë nderi, në mënyrë që lexuesi të bindej më shumë
19 duke parë emrin e tij aty, për ta bërë si më autentike të
20 themi?

21 PË. Sigurisht se po. Kur një vlerësim e jep një profesor i
22 Universitetit të Prishtinës.

23 PY. Ju kujtohet se i keni thënë ZPS-së në intervistë - në
24 Pjesën 1 të saj - që në lidhje me Shukri Bujën nuk jeni madje
25 i sigurt që ai ta ketë lexuar librin? Ju dje thatë se i

1 kërkuat sugjerime z. Buja. Por thatë se ju nuk e dinit që ai
2 madje ta ketë lexuar librin? donit të thoni që ju nuk e dini
3 nëse ai nuk e ka lexuar në thellësi, pra, me imtësi librin?

4 PË. Po, sigurisht nuk muj me dit unë se nuk kam qenë bashkë
5 me të kur e ka bërë ai vlerësimin për atë tashti. Mund të ketë
6 ndodhë që edhe nuk e ka lexu me vëmendje.

7 PY. Po për Dr. Dacin? E dini me siguri nëse e ka lexuar
8 librin apo nëse e ka lexuar librin në hollësi?

9 PË. Po edhe këtë nuk mundem me dit, megjithatë, profesori nuk
10 besoj që e ka lëshu librin pa e lexu.

11 PY. Dua të kaloj tani tek teksti i parathënies, sepse ju vetë
12 nuk keni prova nëse i ka lexuar apo jo librin por ju keni
13 fjalë të cilat i ka përfshirë ai në librin tuaj.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Në fillin të shikojmë hyrjen që vetë
15 dëshmitari ka shkruar për librin e tij që është me numrin
16 036636, versionin në shqip 077053. Faleminderit.

17 PY. Do të përqendrohemi tek ajo që ju vetë keni shkruar në
18 hyrjen tuaj. E njihni që kjo është hyrja juaj për librin tuaj,
19 pra, që janë fjalët tuaja, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dua ta krahasoj me atë që ka thënë Dr. Daci për librin
22 tuaj.

23 Z. TULLY: [Përkthim] Dhe nëse mund të kemi në ekran
24 provën materiale të Mbrojtjes me numër DRS00107 versionin e
25 korrigjuar që kemi dorëzuar dje, ju lutem. Një moment.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dëshironi që të keni --

2 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, vetëm dokumentin në ekran.

3 Faleminderit. Faleminderit.

4 PY. Në të majtë, për t'ju orientuar, pra, në të majtë kam një

5 pjesë nga parathënia e z. Daci dhe në të djathtë është një

6 pjesë nga hyrja juaj. Do të lexoj se çfarë ka thënë Dr. Daci

7 kur fletë arkivat dhe burimet që keni përdorur ju.

8 "Në përgatitjen e kësaj monografie autori është

9 mbështetur dhe ka shfrytëzuar materiale të shumta autentike si

10 shkresa, urdhëresa, raporte, studime të cilat janë të

11 pasistemuara në arkivin e Zonës Operative të Nerodimë, Zonën 6

12 të Trupave Mbrojtëse të Kosovës si dhe në arkivin e Kosovës,

13 gjegjësisht në sektorin e UÇK-së".

14 Ju në hyrjen tuaj në mënyrë të ngjashme thoni "në

15 përgatitjen e këtij punimi jam mbështetur në materiale të

16 shumta autentike, shkresa, urdhëresa, raporte dhe analiza të

17 cilat janë ende të pasistemuara në arkivin e Zonës Operative

18 të Nerodimës, Zonës 6, Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe në

19 arkivin e Kosovës, sektorin e UÇK-së".

20 Dëshmitar, a pajtoheni me mua që, me përjashtim të nja dy

21 fjalësh, po i njëjti formulim që keni përdorur dhe ju në

22 hyrjen tuaj? Pra, është po i njëjti tekst.

23 PY. Saktë. Përafërsisht është i njëjti tekst. Edhe këtu po e

24 dëshmon edhe kur thuhet në dokumenta të shumta. Nëse e marr me

25 librin në libër s'ka dokumenta të shumta. Kështu që po shihet

1 edhe nga këto dy paragrafë edhe ai i profesorit edhe imi se
2 këtu janë rrit gjërat.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Dua të kaloj tani tek tjetra në të
5 njëjtën sekuençë me numrin 108, që përfundon, pra, me numrat
6 108.

7 PY. Ky është po i njëjti proces të themi. Do ta lexoj dhe një
8 herë. Z. Daci thotë kështu:

9 "Siç vërejmë nga dokumentet" --

10 Pra, me emrin e z. Daci:

11 "Siç vërejmë nga dokumentet e shumta është krijuar
12 mundësia për paraqitjen e ngjarjeve më të rëndësishme nga
13 lufta e UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimës. Ndërsa nga
14 aspekti i të dhënave origjinale është mbuluar me fakte,
15 intervista, memoare dhe biseda me drejtuesit e UÇK-së në Zonën
16 Operative të Nerodimës. Autori gjithashtu ka shfrytëzuar edhe
17 një pjesë të shtypit të kohës që është një dëshmi plotësuese
18 në verifikim e të dhënave duke i dhënë kështu mbështetje dhe
19 fuqi më të madhe profesionale dhe shkencore kësaj monografie".

20 Tani që të kursejmë kohë, nuk do lexoj me saktësi se ç
21 keni shkruar ju, po është edhe në këtë rast ekzaktësisht i
22 njëjti tekst, apo jo, pra, si në hyrjen tuaj ashtu edhe në
23 parathënien e z. Daci?

24 PË. Përafërsisht.

25 Z. TULLY: [Përkthim] Pra edhe një dokument të fundit në

1 ekran me numër DRS00109.

2 PY. Dëshmitar, nuk do ta lexoj të gjithën. Sepse është një
3 citim i gjatë.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Mbase mund të shkoni poshtë tek
5 shqipja që t'i shikojmë më mirë dëshmitari.

6 PY. Pra, është marrë nga e njëjta faqe në hyrje. Pra, pjesa e
7 parë në shqip dhe teksti, pra, a janë saktësisht të njëjtat
8 fjalë që keni shkruar dhe ju, pra, këto që janë në emrin e z.
9 Daci janë ekzaktësisht të njëjtat fjalë që keni shkruar dhe ju
10 në hyrjen tuaj?

11 PË. Përafërsisht të njëjtat.

12 PY. Pra, nga parathënia e z. Daci Prokuroria kur ka cituar
13 fjalët e tij të mira për librin tuaj, faktikisht janë thjesht
14 fjalët tuaja, thjesht ai ka kopjuar fjalët tuaja që ju vetë i
15 keni thënë për librin dhe ai ka vendosur emrin e vet përsipër,
16 kështu?

17 PË. Saktë.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse nga ky
19 krahasim i dy teksteve të kalojmë nga faqja, të shohim faqen
20 nga libri i dëshmitarit me fjalët që ai vetë ka shkruar për
21 hyrjen e tij. Që është po kjo faqe, është prova materiale me
22 numër P01015 në faqen 36636.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
24 kundërshtim për këtë?

25 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

1 Z. TULLY: [Përkthim] Janë pjesë nga libri. Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të kemi
3 numër për këtë.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
5 faqja me numër ERN 036636 në anglisht dhe 077053 në shqip i
6 shtohen provës materiale me numër P01015. Klasifikimi publik.

7 Z. TULLY: [Përkthim]
8 PY. Kam edhe një citat tjetër mbi këtë temë dhe është
9 parathënia e Shukri Bujës, është nga prova materiale me numër
10 P0105 në faqen 36631 dhe në shqip është në faqen 077048.

11 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Do të lexojmë nga versioni i katërt poshtë në anglisht
13 nga fundi. Në përgjithësi, pra, Dëshmitar, z. Buja thotë kur
14 fillon me "Ai përdor":

15 "Ai përdor burime të ndryshme goftë të shkruara, kujtime,
16 intervistime, protagonistë të ngjarjeve, të dhëna historike
17 arkivore, dokumente të kohës së luftës për ta ngritë nivelin e
18 librit".

19 Ai përdor, duket, pra, që Shukri Buja përdor një gjuhë më
20 ekonomike, pra, më të pakët, por duket se në thelb përsërit
21 atë që ju vetë keni shkruar në hyrjen tuaj për burimet e
22 përdorura. A pajtoheni me mua për këtë?

23 PË. Saktë.

24 PY. Faleminderit. Do të kaloj në një temë tjetër tani. Do
25 t'ju bëj pyetje për poshtëshënimet, shënimet poshtë faqes --

1 më falni, jo për intervistat. Për intervistat që keni kryer
2 apo siç keni thënë ju bashkëbisedimet.

3 Ju nuk pranoni që të quhen intervista, siç sugjeron
4 Prokuroria, por si bashkëbisedime shoqërore në intervistën
5 tuaj me ZPS-në. Dhe është në Pjesën 1, faqe 21. Në përgjigje
6 të pyetjes:

7 "Pikë së pari, këto intervista që ju citoni janë
8 intervista me personat që i keni bërë ju vetë?"

9 Dhe ju përgjigjeni:

10 "Jo, më shumë se intervista janë bashkëbisedime
11 shoqërore, pra, si bashkëluftëtarë pas lufte kena bisedu,
12 mbasi ka mbaru lufta".

13 Pra, janë muhabet të themi, janë biseda të thjeshta dhe
14 jo intervista formale. Kështu?

15 PË. Saktë. Biseda bashkëluftëtarët me bashkëluftëtarët.

16 PY. Dhe, unë po e supozoj këtu, po nuk e di a e kam kuptuar
17 saktë, se ma merr mendja ju nuk keni përdorur ndonjë diktofon,
18 ndonjë incizues për ta incizuar intervistën si një intervistë
19 zyrtare? Thjesht keni mbajtur shënim ndërkohë që bënit këto
20 biseda, apo jo?

21 PË. Nuk kemi përdor, nuk kemi incizu ato biseda fare. Vetëm
22 kemi bashkëbisedu me të dhe i kemi bë shënimet.

23 PY. Pra, asnjëherë nuk keni mbajtur shënim me shkrim ju vetë
24 se për çfarë keni bisedu? As kështu ndonjë shënim të shkurtër
25 të themi?

1 PË. Shënime të shkurtra kohë pas kohe, po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi nevojë
3 për pushimin në orën 10.00. Thjesht që ta dini.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Do ta përfundoj këtë, shumë pak.

5 PY. Pra, nuk është se ju keni bërë një zbardhje të tekstit
6 fjalë për fjalë se çfarë ka thënë personi tjetër gjatë
7 bisedës, por keni mbajtur ndonjë shënim të shkurtër aty-këtu.
8 Por jo se keni mbajtur shënim fjalë për fjalë se çfarë ka
9 thënë bashkëbiseduesi?

10 PË. E saktë.

11 PY. Duke qenë se shënimet nuk janë perfekte, të përsosura,
12 mund të keni futur edhe informacione të cilat nuk ia ka thënë
13 bashkëbiseduesi, por që thjesht jua ka marrë mendja juve, keni
14 bërë një lloj perifrazimi me fjalët tuaja duke futur aty dhe
15 supozimet tuaja sesi mund të kenë qenë gjërat?

16 PË. Sigurisht, për atë edhe e kam thënë edhe në sesionet e
17 kalume disa herë se i kam rrit gjërat. I kam zbukuru gjërat, i
18 kam zmadhu gjërat.

19 PY. Atëherë faleminderit.

20 Z. TULLY: [Përkthim] Do ta përfundoj pas pushimit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
22 të bëjmë pushim prej dhjetë minutash. Asistentja e sallë do
23 t'ju shoqërojë që të dilni nga salla. Mos flisni me askënd për
24 dëshminë tuaj me askënd.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 28

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
2 një pushim të shkurtër prej dhjetë minutash. Do të rikthehemi
3 në orën 10.10.

4 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

5 --- Seanca rifillon në orën 10.10

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente,
7 sillni dëshmitarin në sallë.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar do
10 të vazhdojmë tani me pyetjet e z. Tully.

11 Z. Tully, fjala është për ju.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit.

13 PY. Mirë se u kthyet, Dëshmitar.

14 PË. Faleminderit.

15 PY. Do të vazhdoj tani dhe do flasim për shënimet në fund të
16 faqes që keni përdorur në librin tuaj. A e kam kuptuar unë siç
17 duhet, që përkrah intervistave që diskutuam dhe burimeve të
18 tjera që kemi përdorur si referenca në librin tuaj, ju nuk
19 keni mbajtur kopje? Nuk ka asnjë dokument kopje fizike që ne
20 të kemi mundësi të inspektojmë ato burimet që keni përdorur
21 ju, kështu?

22 PË. E saktë.

23 PY. Unë po ju parashtroj dhe në fakt ju e keni bërë të qartë
24 që ju keni përfshirë informata në libër që nuk vijnë na
25 burimet që keni përdorur ju për këtë libër. Dhe do ju jap dy

1 shembuj nga ngjarjet që lidhen me vdekjen e Qamil Ilazit dhe
2 do ta lidh me diçka që ju pyeti dhe Prokuroria për Shukri
3 Bujën.

4 Pyetjet e mia nuk lidhen me faktet e incidentit në
5 vetvete po mënyra sesi i keni pasqyruar ju burimet.

6 Z. TULLY: [Përkthim] Dhe për këtë do të doja që të
7 shfaqej në ekran teksti që lexon "Nga lufta e UÇK-së në
8 Operacionin e Nerodimës", që mban numrin 036717 dhe në shqip
9 077138.

10 Do t'ju lexoj -- më falni sa ta gjejmë, fjalia që
11 përfundon me shënimin 137. Keni bërë një përshkrim të
12 ngjarjeve që çuan në vdekjen e Qamil Ilazit në maj të 1999 dhe
13 incidenti i parë që ka ndodhur në maj, ju thoni si në vijim:

14 "Njësitë gueril të Brigadës 162 Agim Bajrami duke vëzhguar
15 terrenin më 7 maj 1999, te ura e Krivarekës ndërmori një
16 aksion duke i vrarë dy ushtarë serb e duke i plagosur disa të
17 tjerë. Dhe ua shkatërroj krejtësisht automjetin e luftës".

18 Në poshtëshënim, është poshtëshënimi 137.

19 Z. TULLY: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë në fund të faqes
20 që të shohim çfarë thotë shënimi 137.

21 PY. Ju keni folur për këtë incident të majit 1999 dhe thoni
22 që e keni marrë këtë informatë nga Rufki Suma, komandant i
23 Batalionit të Tretë, raporti me shkrim i 24 prillit 1999.

24 A pajtoheni me mua që nuk është e mundur që ta keni marrë
25 këtë informatë nga një raport që të jetë bërë disa javë para

1 se të ndodhte vetë incidenti?

2 PË. Sigurisht se pajtojna me ju.

3 PY. Edhe sikur vetë për të përshkruar burime, pozicionin e
4 këtij njësiti gueril, ju keni plotësuar vetë detale duke
5 përdorur hamendësimet tuaja, apo jo, keni bërë referenca për
6 diçka dhe keni thënë jeni bazuar në një raport që e keni marrë
7 një javë para se të ndodhte ngjarja në vetvete, pra, i keni
8 hamendësu vetë, a është kështu?

9 PË. E saktë.

10 PY. Poshtëshënimi as nuk flet për batalionin që keni
11 përmendur ju -- më falni, jo.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Shkojmë pak më lartë. Jo, më poshtë
13 në faqe, te fjalia që fillon "Në të njëjtën ditë" thotë "Në të
14 njëjtën ditë".

15 PY. E njëjta gjë. Keni përshkruar një ngjarje që ka ndodhur
16 më 11 maj. Ka ndodhur një sulm, keni përshkruar një sulm në
17 Çakaj, në lagjen e Çakëve në fshatin Bob që ka ndodhur një
18 sulm në këtë zonë. Edhe këtu po ashtu keni cituar tek
19 poshtëshënimi, poshtëshënimi 140, thoni që po ashtu këtë e
20 keni bazuar në një raport me shkrim nga Heset Malsiu. Po s'ka
21 mundësi ta keni mbështetur atë që keni në tekst në këtë
22 poshtëshënim.

23 PË. Kjo thjesht ka qenë ashtu qysh kemi dashtë edhe që e kam
24 thënë edhe shumë herë që e kam zmadhu e kam zbukuru.

25 PY. Unë dua të dal këtu, e keni pas zakon përgjatë librit --

1 unë vetëm dy shembuj ju dhashë se s'i kam të gjitha burimet
2 origjinale. Por vetëm bazuar në këto shembuj ne kuptojmë që ju
3 e keni ekzagjeruar keni përfshirë hamendësimet tuaja dhe nuk i
4 keni të bazuara në informata konkrete. A pajtoheni me mua?

5 PË. Po, pajtojna.

6 PY. Tani, dua të flas për një pyetje që i keni dhënë
7 Prokurorisë. Kjo është reflektuar në transkriptin e ditës së
8 djeshme, faqja 36 dhe fillon në rreshtin 8. Ju bëri pyetje
9 Prokurori lidhur me një citim që keni në libër që është në
10 faqen 036622 deri në 06837 -- jo, më falni, i thashë gabim
11 faqet, është faqja 036645 dhe nuk është nevoja të shfaqet në
12 ekran. Prokurori ju pyeti dhe ju tha:

13 "... Do t'ju lexoj dhe një herë këtë citimin dhe kushtoi
14 rëndësi sepse pas kësaj do t'ju bëj disa pyetje që t'i tregoni
15 Trupit Gjykues se çfarë keni zbukuru dhe çfarë keni
16 ekzagjëru".

17 Dhe ju keni thënë:

18 "Me urdhër të UÇK-së, të Shtabi Përgjithshëm të UÇK-së
19 Shukri Buja rikthehet në Kaçanik dhe zbaton urdhrin e shtabit
20 të UÇK-së për të emëruar Agim Bajramin si komandant të
21 njësitit të Kaçanikut".

22 Dhe ju u përgjigjët, e mohuat, thatë që s'kemi parë
23 ndonjë urdhëresë dh thatë që:

24 "... Shukri Buja nuk më tha se është shkruar kështu, por
25 që e ka emëruar ai si një komandant të njësitit të Kaçanikut".

1 Pra, shembulli që kemi këtu ka lidhje me këtë që keni
2 perceptuar ju dhe nuk ju ka thënë konkretisht Shukri Buja, apo
3 jo?

4 PË. Saktë.

5 PY. Faleminderit.

6 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

7 PY. Dhe ju uroj rrugë të mbarë, Dëshmitar.

8 PË. Faleminderit.

9 Pyetje të palës tjetër nga Z. Ellis:

10 Z. ELLIS: [Përkthim]

11 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

12 PË. Mirëdita.

13 PY. Unë quhem Aidan Ellis dhe përfaqësoj z. Jakup Krasniqi.

14 Dua të filloj me dëshminë që keni dhënë për kushtet e vështira
15 sesi keni operuar ju në zonën e Kaçanikut.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Do lutesha të shfaqej në ekran
17 DJK00343.

18 PY. Dëshmitar, e shihni një hartë në ekran. Ku shikoni

19 Kaçanik. E shihni Kaçanikun në hartën në ekran?

20 PË. Po.

21 PY. Faleminderit. Do t'ju kërkoj të vendosni një numër tek
22 vendet që keni përmendur në dëshminë tuaj. Na thoni nëse keni
23 nevojë që të zmadhohet më shumë harta.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Por do i lutesha ndërkohë Asistentes
25 t'ju japi një laps.

1 DËSHMITARI: Me rrit bën edhe pak.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë zmadhojmë fillimisht zonën
3 pranë Kaçanikut. Më poshtë, ju lutem.

4 DËSHMITARI: Mirë është.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Dëshmitar, ju përmendët disa fshatra ku kishte prani UÇK-
7 ja. Ju përmendët Ivajën. E shihni Ivajën në hartë?

8 PË. Ivajën, po.

9 PY. A mund të vendosni një shënim atje ju lutem.

10 PË. [Shënon]

11 PY. Gajren? Gajra?

12 PË. [Shënon]

13 PY. Biqec?

14 PË. [Shënon]

15 PY. Po ashtu përmendët Bobin. E shihni dot Bobib në hartë?

16 PË. Vetëm e kam përmend malet e Bobit, mbi fshatin Bob, jo
17 Bobin.

18 PY. Po. Se fshati Bob është shumë afër Kaçanikut, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Pra, vendi ku duhet të ketë qenë UÇK-ja i bie mbi fshatin
21 Bob, kështu?

22 PË. Mbi fshatin Bob, te kulla e Hasanit më konkretisht.

23 PY. Situata ishte aso kohe që UÇK-ja kishte grupe të vogla
24 luftëtarësh në secilin prej këtyre fshatrave. Kështu ishte,
25 apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe ishte e vështirë të lëvizje nga një fshat tek tjetri
3 për shkak të pranisë së forcave serbe që ishin pranë, kështu?

4 PË. Shumë vështirë ka qenë se forca serbe ka pasur edhe në
5 anën e majtë të lumit Lepenc apo rrugës kryesore që shkon për
6 Shkup dhe anën e djathtë të lumit gjithashtu edhe nga pjesa e
7 kufirit me Maqedoninë, pjesën që lidh me Tetovën dhe
8 Boboshicën. Në të gjitha këto vende ka pasë forca okupatore
9 serbë.

10 PY. Meqë e përmendët le të flasim për këtë.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] I drejtohem Asistentes nuk e di nëse
12 është e mundur të kemi një laps me ngjyrë tjetër?

13 Faleminderit.

14 PY. Nëse e kuptova siç duhet, vetë qyteti i Kaçanikut
15 kontrollohej nga forcat serbe, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. A mund të na e shënoni me këtë ngjyrën e re që i
18 vendosëm?

19 PË. Kaçanikun, apo?

20 PY. Po.

21 PË. [Shënon]

22 PY. Faleminderit. Në hartë mund të shihni dhe pikën e kalimit
23 kufitar për në Maqedoni. Besoj se e para është Gllobocicë. Më
24 falni se nuk i shqiptojmë dot mirë, na mirëkuptoni për këtë.

25 PË. [Shënon]

- 1 PY. Edhe kjo kontrollohej nga forcat serbe, apo jo?
- 2 PË. Edhe kjo, po.
- 3 PY. Ana tjetër kemi tek Hani i Elezit kemi pikën tjetër të
4 kalimit kufitar.
- 5 PË. Edhe kjo kontrollohej nga forcat okupatore serbe dhe
6 aparati shtetëror okupues.
- 7 PY. Mund të shohim dhe një magjistrale këtu nga Hani i Elezit
8 që shkon drejt Kaçanikut dhe vazhdon lart për në Ferizaj. E
9 shihni?
- 10 PË. Po.
- 11 PY. Kjo ishte pjesë e magjistrates nga Prishtina për në
12 Shkup, apo jo?
- 13 PË. Po.
- 14 PY. Dhe kjo magjistrale po ashtu kontrollohej nga forcat
15 serbe të cilët kishin pika kontrolli përgjatë kësaj, apo jo?
- 16 PË. Në të gjitha anët ka pas forca okupatore serbe. Kishte
17 dhe hekurudhë, kishte dhe hekurudhë pranë kësaj magjistrale
18 apo jo, shina?
- 19 PË. Po, hekurudhat nëpër Kaçanik, po nuk shkon ka
20 magjistranja.
- 21 PY. E kuptoj. Po edhe hekurudha kontrollohej na aparati serb,
22 apo jo?
- 23 PË. Nga aparati okupues serb.
- 24 PY. Mund të shihni në hartë nga e majta Shtërpcën.
- 25 PË. Po.

1 PY. Edhe ky ishte një qytet tjetër që kontrollohej nga forcat
2 serbe, apo jo?

3 PË. Nga forcat okupatore serbe.

4 PY. Dhe magjistratja nga Shtërpca drejt Kaçanikut, po ashtu
5 kontrollohej nga forcat serbe, kështu?

6 PË. Gjithashtu kontrollohej edhe kjo nga forcat okupatore
7 serb edhe në çdo 2, 3, 100 metra ka pas punkte policore,
8 punkte paramilitare, punkte ushtarake.

9 PY. Po punkte të UÇK-së nuk kishte në zonën tuaj, apo jo?

10 PË. Edhe një herë pyetjen ju lutem?

11 PY. Po, i keni dhënë një përgjigje Prokurorisë në intervistë.

12 Ju pyeti Prokuroria:

13 "Po UÇK-ja a kishte pika kontrolli në zonën e Kaçanikut?"

14 Dhe ju jeni përgjigjur:

15 "Jo, nuk ka pasur".

16 Kështu?

17 PË. Jo, nuk ka pasur.

18 PY. A është e vërtet që në zonën e Shtërpcës janë disa

19 fshatra ku kishin shumicën e popullatës serbe?

20 PË. E vërtet është.

21 PY. Dhe këto fshatra nuk u sulmuan asnjëherë nga UÇK-ja gjatë
22 konfliktit, e vërtet?

23 PË. Asnjëherë.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të ruajmë këtë imazh dhe

25 zmadhojmë pak më shumë?

1 Mund ta zmadhojmë edhe pak më shumë, ju lutem, hartën ose
2 më saktë shkojmë më lartë. Pak më lart.

3 Besoj se fshimë dokumentin me shënime. A është e mundur
4 që ta rikthejmë të njëjtin imazh ku patëm shënimet përkatëse
5 apo mund t'i bëjmë nga e para.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem bëni shënimet
7 në këtë imazh dhe më pas do ta ruajmë edhe këtë.

8 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
9 këshillohen]

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju faleminderit. Atëherë a mund të
11 shënojmë vendet e reja që doja të përmendja dhe më pas t'i
12 shfaqim të dyja hartat krahas krahas nëse është e mundur.

13 Shkojmë pak më lartë që të shohim fillimin e hartës.

14 PY. Dëshmitar, vetë Ferizaj po ashtu kontrollohej nga forcat
15 serbe, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. A mund ta shënoni me ngjyrën e gjelbër?

18 PË. [Shënon]

19 PY. Edhe Shtimja nga forcat serbe kontrollohej, kështu?

20 PË. Gjithashtu kontrollohej edhe kjo nga forcat serbe edhe
21 pse edhe Shtimja edhe Ferizaj nuk kanë qenë kompetencë e imja.

22 PY. E kuptoj.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë tek harta me ngjyrë të kuqe,
24 më falni, mund të nxjerrim edhe një herë ngjyrën e kuqe si në
25 laps.

1 PY. A është e drejtë që në Jezercë ishte Brigada 161

2 ndonjëherë, kështu?

3 PË. Ka qenë, mund të ketë qenë kështu, po nuk ka qenë Jezerci

4 kompetencë e imja, ju lutem.

5 PY. E kuptoj këtë, Dëshmitar. Po në hartë e shikon Jezercën?

6 PË. Po.

7 PY. Faleminderit. Mesa keni dijeni, komanda e zonës një herë

8 ishte në Mollopolc e Nerodimës?

9 PË. Nuk e di saktë, për shkak se nuk ka qenë kompetencë e
10 imja.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] A është e mundshme t'i nxjerrim tani
12 hartat krah për krah? Ju lutem ruani dhe këtë edhe nxirrni dhe
13 hartën tjetër përbri kësaj?

14 PY. Tani, ju keni operuar në zonën e Kaçanikut, Dëshmitar,
15 kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe jeni të rrethuar nga forcat serbe në kufi, në
18 magjistralen që kalonte përmes Kaçanikut, nga të gjitha
19 drejtimet, kështu?

20 PË. E vërtet.

21 PY. Fshatrat ku operonit ju, ne i shohim në hartë, është
22 terren goxha malor, apo jo?

23 PË. Malor është.

24 PY. Pra, imagjinojmë si ka qenë situata. Keni qenë në një
25 situatë ku keni pasur forcat serbe që ju granatonin, që

1 granatonin në magjistrale, në fshatra edhe luftëtarët tuaj nga
2 të gjitha anët, kështu?

3 PË. E vërtet.

4 PY. Dhe kushtet si për ju dhe për civilët në ato fshatra në
5 atë kohë kanë qenë shumë të vështira, apo jo?

6 PË. Shumë të vështira.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
8 pranohen si prova këto dy harta me të cilat bëmë dhe shënimet
9 përkatëse.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
11 çaktivizuar].

12 Na jepni numrat edhe një herë.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Po. Kanë numër DJK00643 me shënimet
14 përkatëse.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di a
16 është e mundur në qoftë se i ndajmë dot A dhe B? Domethënë,
17 DJK00643 pranohet, është kërkuar që të pranohet. Ka
18 kundërshtime nga Prokuroria?

19 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
21 pranohet dhe do të marrë numrin e provës materiale, por do t'i
22 ndajmë në A dhe në B.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
24 shënimet që ka bërë dëshmitari 04576 në dokumentin ERN DJK0643
25 do të marrin numrin e Zyrës Administrative REG001169 dhe

1 numrin e provës materiale 4D00029.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
3 atëherë. Nuk do të përdorim A dhe B, po do u japim dy numra të
4 ndryshëm.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ndërsa harta e dytë do
6 të ruhet me numrin REG01170 dhe merr numrin e provës materiale
7 4D00030.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

9 PY. Dëshmitar, në atë kohë komunikimi me telefona ishte shumë
10 i rrallë për shkak të çështjeve të sigurisë, apo jo?

11 PË. I rrallë dhe lirisht mund të them që nuk ka qenë fare.

12 PY. Dhe aspekti i sigurisë ishte që e dinit nëse do t'i
13 përdornit, mund t'i përgjonin forcat serbe, kështu?

14 PË. E vërtet.

15 PY. Dhe s'ka dyshim edhe për shkak se operonit në male do të
16 kishte probleme me valët me telefonat ndaç ato mobil, ndaç
17 telefona të thjesht, kështu?

18 PË. Ashtu është.

19 PY. Ju pyetën në intervistën me Prokurorinë edhe për disa
20 distanca dhe ju keni thënë se duheshin 12-13 orë për të
21 mbuluar distancën, largësinë nga fshati juaj në Kaçanik dhe
22 Mollopolc. Është i saktë ky vlerësim?

23 PË. Edhe më shumë orë. Dhe më shumë orë. Tuj e pasë parasysh
24 të gjitha vendet kryesore kanë qenë të mbuluara me forcat
25 okupatore serbe.

1 PY. Po, se në atë kohë luftëtarët tuaj kalonin, lëviznin në
2 këmbë, ecnin për të shkuar nga një vend tek tjetri, kështu?

3 PË. Ashtu është.

4 PY. Dhe s'mund ta përdornin magjistralen sepse e dinit që
5 kishte pika kontrolli serbe çdo 100, 200 metra thatë ju?

6 PË. Sigurisht se po. Po jo vetëm magjistralen po edhe rrugët
7 lokale kanë qenë të kontrolluara me punkte nga forcat
8 okupatore serbe.

9 PY. Pra, çdo korrier që duhet të përcillte ndonjë porosi nga
10 zona juaj duhet të ecte shumë në këmbë dhe më pas të priste
11 për përgjigjen dhe të kthehej po përsëri në këmbë, apo jo?

12 PË. Jo vetëm që do të ecte në këmbë, por edhe rrezikun e
13 kishte 100 për qind.

14 PY. Po, sepse po ndalonin në postblloqet serbe do të
15 arrestoheshin, apo jo?

16 PË. Sigurisht. Do të arrestoheshin, do të keqtrajtoheshin
17 edhe vraheshin, qysh janë vra më shumë se 15 mijë qytetarë të
18 Republikës së Kosovës.

19 PY. Dhe është e vërtetë, apo jo, që në janar të vitit 1999
20 nuk kishit mjaftueshëm pajisje komunikimi brenda kësaj njësie?
21 Është e vërtetë kjo, apo jo?

22 PË. E vërtetë është.

23 PY. Dhe madje dhe i keni thënë Prokurorisë që:

24 "Në raste të caktuara kalonin muaj të tërë gjersa
25 komandanti i brigadës, pra, që takohej me komandantin e

1 zonës".

2 Edhe kjo është e vërtet duke pasur parasysh edhe
3 distancat?

4 PË. Jo vetëm një korrigjim këtu. Kam thënë që unë si
5 zëvendëskomandant ka ndodh që më shumë se një muaj nuk kemi
6 pas mundësi të takohemi me komandantin e brigadës. Se për
7 komandantin e brigadës me komandantin e zonës nuk kam pas
8 njohuri.

9 PY. Pra, për vetë takimet tuaja me komandantin e brigadës
10 tuaj po thoni që kalonte një muaj, rreth një muaj?

11 PË. Ka pas raste që edhe ka kaluar një muaj e më shumë se një
12 muaj për shkak të zhvillimeve shumë të ashpra të rënda të
13 luftës që ka ndodhë në ato pjesë dhe për shkak të terrenit
14 shumë të vështirë që e thamë edhe më herët.

15 PY. Do të kaloj tani në një tjetër temë.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund t'i heqim hartat nga ekrani.

17 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje për Jakup Krasniqin.
18 Është e vërtet, apo jo, që ju vetë nuk e keni takuar z.

19 Krasniqi gjatë konfliktit në vitin 1998 apo 1999, nuk keni
20 pasur asnjë kontakt tjetër me të?

21 PË. Gjatë luftës çlirimtare asnjëherë nuk e kam takuar z.
22 Krasniqi.

23 PY. Por të gjithë e dinin që z. Krasniqi ishte zëdhënësi i
24 UÇK-së, apo jo?

25 PË. Kemi ndëgjuar ku kemi pas mundësi përmes mjeteve të

1 informimit, aq sa kemi pas mundësi.

2 PY. Ishte i vetmi rol në dijeninë tuaj që kishte ai gjatë
3 konfliktit, apo jo?

4 PË. Sipas njohurive të mia i vetmi rol ka qenë ai.

5 PY. Dëshmitar, ju folët pakëz për Qamil Ilazin sot dhe dje.

6 Është e vërtet, apo jo, që Qamil Ilazi njihej ndryshe si
7 komandant Bardhi?

8 PË. E vërtet.

9 PY. Dhe ishte udhëheqësi i njësitit të Kaçanikut që më vonë u
10 bë brigadë nga rreth gushtit 1998 gjersa ra në maj të 1999?

11 PË. Po.

12 PY. Në periudhën nga marsi deri në maj të 1999, forcat serbe
13 po sulmonin fshatrat e zonës së Kaçanikut dhe UÇK-ja shkonte
14 sa në një fshat në tjetrin për t'i mbrojt disa fshatrat dhe
15 civilët me aq sa kishin mundësi, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Pra, të gjithë anëtarët e UÇK-së në Kaçanik ishin të
18 ekspozuar ndaj sulmeve serbe, të forcave serbe gjatë asaj
19 kohe, apo jo?

20 PË. E saktë.

21 PY. Më 14 maj të 1999, Qamil Ilazi po inspektonte njësitë e
22 Batalionit të Dytë dhe të Tretë kur ra në pritë të forcave
23 serbe në fshatin e Nikocit. Kështu është, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Jo vetëm Qamil Ilazi, por edhe Selim Shehu u vra në pritë

1 edhe Shefqet Kuka u plagos. Kjo është e vërtetë, apo jo?

2 PË. E vërtetë.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Në ekran kërkoj të shfaqet dokumenti
4 me numër P625, ju lutem.

5 PY. Do të presim që të dali gjuha shqipe.

6 Dëshmitar, jua ka treguar Prokuroria këtë dokument. Besoj
7 se është e vërtetë nëse them që nuk e keni parë këtë dokument
8 në janar të 1999, apo jo?

9 PË. As në janar nuk e kam parë, por asnjëherë derisa
10 Prokuroria ma ka prezantuar këtë dokument nuk e kam pa
11 asnjëherë.

12 PY. Pra, nuk keni asnjë informacion nëse këtë dokument e ka
13 pranuar ndonjëherë Brigada 162 apo zona e Nerodimës? Nuk keni
14 informacion për këtë?

15 PË. Nuk kam asnjë informacion. Unë nuk kam parashtrim gjatë
16 luftës asnjë informacion për këtë dokument. Atë çka e di të
17 sigurt se komandanti i brigadës ka udhëheq me brigadën nga
18 fillimi deri më 14 maj ku edhe ka ranë në krye të detyrës.

19 PY. Pra, mund të konfirmoni që komandant Bardhi vijoi të
20 ishte komandant deri më datë 14 maj kur ra në luftime në
21 pritën e forcave serbe. Është e vërtetë kjo?

22 PË. E vërtetë është. Që ka komandu me njësitë e Brigadës 162
23 deri në 14 maj kur ra heroikisht në krye të detyrës. Këtë e
24 them me plot përgjegjësi se zëvendëskomandant i komandant
25 Bardhit kam qenë unë.

1 PY. Kalojmë në një dokument tjetër.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani P168 e kërkoj që të paraqitet
3 në ekran, ju lutem. I njëjti numër si në anglisht ashtu edhe
4 në shqip.

5 PY. Dëshmitar, ky është një dokument tjetër të cilin jua ka
6 treguar Prokuroria edhe ky është dokument të cilin ju nuk e
7 keni parë gjatë konfliktit, madje e patë për herë të parë kur
8 jua tregoi Prokuroria. Kështu është, apo jo?

9 PË. Është e vërtet. Edhe në Prokurori e kam thënë që
10 asnjëherë nuk e kam parë këtë dokument. Po edhe sikur ta kisha
11 parë nuk e kisha pranuar absolutisht pa emën edhe mbiemën,
12 atëherë e kam thënë se vetëm nënshkrimi nuk do të thotë për
13 mua asgjë dhe ka qenë, kish me qenë i papranueshëm. Por ajo
14 çka me rëndësi, nuk e kam pa asnjëherë këtë dokument pari.

15 PY. Pra, nuk e njohët as nënshkrimin, nuk e njihnit?

16 PË. Nuk e kam njoft.

17 PY. Dhe ajo i thatë Prokurorisë është që për ju s'është e
18 besueshme se s'ka as emër as mbiemër në fund. Kështu keni
19 thënë, apo jo?

20 PË. E saktë.

21 PY. Po nuk ishit në dijeni se ekzistonte një urdhër i tillë
22 nga Shtabi i Përgjithshëm gjatë 1998 apo 1999, apo jo?

23 PË. Asnjëherë nuk kam ndëgjju për këtë urdhër.

24 PY. Po. Faleminderit.

25 Z. TULLY: [Përkthim] Mund ta heqim këtë.

1 PY. Në seancën përgatitore që keni bërë me Prokurorinë i
2 thatë Prokurorisë që kryetari i komunës serbe Kaçanik apo
3 kryetari serb i komunës Kaçanik quhej Ognjenovic. Do më
4 ndihmonit me shqiptimin, z. Dëshmitar, se e njihni, besoj e
5 kuptoni për kë e kam fjalën.

6 PË. Kryetari i komunës nga administrata okupatore serbe ka
7 qenë Ognjenovic Rado -- nuk. Kur ta shoh mbi dokumentin ja u
8 lexoj saktë.

9 PY. Jo, nuk po flas për ndonjë dokument tani, Dëshmitar.
10 Thjesht po ju bëj një pyetje --

11 PË. Orsat Ognjenovic.

12 PY. Dhe ishte Ognjenovic ai që ngriti një forcë policore
13 lokale në Kaçanik, kështu?

14 PË. Po. Po, saktë. Ognjenovic ka qenë nga administrata
15 okupatore serbe në Kaçanik.

16 PY. Dhe kishte një forcë policore lokale që vepronte në atë
17 zonë e cila përbëhej nga serbë dhe nga disa shqiptarë, kështu
18 është?

19 PË. Ashtu është. Se pak ju ka duk se ka forca serbe Serbia me
20 forcat ushtarake policore paramilitare, po ka formu edhe disa
21 njësi lokale.

22 PY. Dhe me aq sa dini ju, këto njësi të policisë lokale
23 punonin me policinë serbe me ushtrinë serbe, me
24 paraushtarakët. Pra, ishin pjesë e forcave kundërshtarë, apo
25 jo?

1 PË. Sigurisht. Pjesë e formacioneve policore, ushtarake,
2 paramilitare serbe. Edhe Ognjenovic përveç i ka pas
3 përgjegjësinë që i ka formu atë njësi lokale, ai ka
4 përgjegjësinë që duhet të dalë para drejtësisë edhe për
5 vrasjen e më shumë se 200 qytetarëve të Kaçanikut që është
6 drejtpërdrejt përgjegjës ai me këto forca dhe forca tjera.
7 PY. Ju, Dëshmitar, i jeni përgjigjur disa pyetjeve nga z.
8 Misetić sot paradite sa i takon komunikatave dhe deklaratave
9 politike. Me sa kuptova, ju thatë që nuk i keni parë ato aso
10 kohe. Por duke qenë se pas konfliktit ju keni bërë punë
11 hulumtuese për librat tuaj, ju thatë që i keni ndjekur dhe
12 keni përcjellë disa prej seancave të TPNJ-së.

13 A keni pasur mundësi që të shihni disa prej këtyre
14 komunikatave dhe deklaratave politike tani së vonshmi të
15 themi?

16 PË. Thjesht nuk jam lëshu në studimin e tyre për shkak se i
17 kam pa që në të gjitha proceset që janë zhvillu, ka pas më
18 shumë montime sesa realitet. Kështu që, nuk kam pas vullnet që
19 të shoh për na një studim të veçantë për to.

20 PY. Dhe ngaqë ju mendoni se këto dokumente përmbajnë më shumë
21 montime sesa të vërteta? Këtë po përpiqeni të thoni?

22 PË. Sigurisht se po. Është një rast që gjatë Tribunalit të
23 Hagës një dëshmitar, nuk po më kujtohet tash emri, po janë
24 shënimet, shkon me gjëra të pavërteta, fletë aty kur thotë se
25 i kemi gjet një ditarin e Hajrush Kurtajt në fshatin Gabrricë,

1 në shtëpinë e tij kur është sulmu shtëpia më 10 gusht. Në
2 fakt, ato as nuk i kanë gjet. As nuk jam kanë un aty. Dhe
3 thotë me atë rast e vramë Hajrushin edhe i vramë edhe dy të
4 tjerë. Qe Hajrushin sot jam para jush këtu.

5 Domethënë, edhe me kësi gjërash është marrë ish-Tribunali
6 i Hagës edhe dëshmitarët edhe aparati okupues serb.

7 PY. Dëshmitar, do t'u kthehem nja dy pyetjeve sa i takon
8 librit tuaj përsëri. Ju shpjeguat shumë qartë tashmë se libri
9 juaj përmban zbulime. Nuk kam asnjë dyshim, keni dijeni se
10 shumë anëtarë të UÇK-së kanë shkruar libra për luftën por pas
11 lufte i kanë shkruar këto libra. Nuk kam dyshim që ju jeni të
12 familjarizuar edhe me disa prej këtyre librave, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe në ato vepra që ju keni lexuar shumë prej këtyre
15 librave e zmadhojnë rolin që ka luajtur organizata dhe
16 organizimin i UÇK-së?

17 Z. PACE: [Përkthim] Kemi kundërshtim. Duhet bërë pyetje
18 më konkrete dhe jo në teori për këto libra, nuk ka bazë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hidhet
20 poshtë. Rrëzohet kundërshtimi. Do t'ju përgjigjeni pyetjes së
21 përgjithshme por duhet të jeni, por mund të jepni edhe emra
22 pastaj nëse dalin.

23 Z. ELLIS: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, doni t'ju përsëris dhe një herë pyetjen?

25 Pyetja ishte kjo: Në veprat, në librat që ju keni lexuar,

1 shumë prej këtyre librave e zmadhojnë rolin që ka luajtur vetë
2 autori i atyre librave dhe organizimi që ka pasur UÇK-ja,
3 kështu, apo jo?

4 PË. Sigurisht se po. E kam thënë edhe në seancat e tjera.
5 Gjithherë Ushtria Çlirimtare e Kosovës kur e shkruan Ushtria
6 Çlirimtare, në përgjithësi, e shkruajnë historinë, kur ta
7 shkruajnë Ushtria Çlirimtare historinë shkruan për qëndresën e
8 njësiteve çlirimtare, për sakrificën e kombit, për heroizmin e
9 dëshmorëve të kombit, për lavdinë. E kur të shkrun për lavdinë
10 e dëshmorëve çdo person që shkruan në libër atë është shumë
11 normale që ka me i rritë gjërat, ka me i zmadhu gjërat. Dhe
12 pajtojna edhe me konstatimin edhe të juaj.

13 PY. Është vijim, si të thuash, i propagandës që bëhej që në
14 kohë të luftës të themi?

15 PË. Sigurisht. Për në kohë lufte është bërë për frymëzimin e
16 të gjithëve që të ecim përpara drejt lirisë e mbas lufte për
17 gjenerata të reja që të jetë shembull sesi duhet të mbrohet
18 vendi, kombi e tjera.

19 PY. Shoqëria në Kosovë, në përgjithësi, i respekton
20 shkrimtarët dhe autorët e librave, apo jo?

21 PË. E saktë. I respekton.

22 PY. Nuk është se ju vetë t'i keni kritiku autorët e këtyre
23 librave për t'u thënë që shiko se e keni zmadhu pak, apo jo?

24 PË. Nuk kam pas rast që të bisedoj rreth këtyre gjërave.

25 PY. Folët dje, por edhe sot pakëz, për arkivën e TPK që ishte

1 si burim i disa prej dokumenteve për librin tuaj. Po për të
2 qenë të qartë, në Brigadën 162 ju s'kishit as garnizon, as një
3 vend ku të mbanit dokumentacionin apo ta krijonit këtë
4 dokumentacion. Kështu është?

5 PË. Po absolut. Në kohë lufte, na për male, s'kemi pas
6 mundësi të kemi garnizone. Kur kemi qenë të rrethuar nga të
7 gjitha anët nga forcat serbe, nga forcat okupatore serbe.

8 PY. Nuk keni dijeni se ka pasur ndonjë sistem të organizuar
9 për të mbajtur dokumentet gjatë luftës, apo jo?

10 PË. Nuk jam në dijeni.

11 PY. Dhe nuk e dini sesi janë futur dokumentet në arkivën e
12 TPK-së, apo jo?

13 PË. Nuk e di.

14 PY. Nëse individët kanë sjellë dokumente në arkivat e TMK-së
15 gjatë kohës, ju nuk e dini domethënë as këtë?

16 PË. Nuk kam njohuri.

17 PË. Kur keni marr dokumente nga arkiva nuk është se kishte
18 ndonjë evidencë aty për të treguar se nga ishte prejardhja e
19 këtyre dokumenteve? Si kishin hyrë në arkiv, apo jo?

20 PË. Unë nuk kam parë asnjë dokument të tillë.

21 PY. Dhe ju vetë s'keni dijeni, nëse arkiva ka bërë ndonjë
22 verifikim të origjinalitetit të dokumenteve? Nuk është se jeni
23 në dijeni të ndonjë verifikimi të tillë për autenticitetin e
24 tyre?

25 PË. Nuk jam në dijeni.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 51

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është momenti,
2 po shoh orën. Mos është ky momenti për të bërë pushimin?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
4 pushimin e paradites prej gjysmë ore. Dëshmitar, Asistentja e
5 Sallës do t'ju shoqëroj të dilni nga salla. Ju lutem mos
6 flisni me askënd për dëshminë tuaj që keni dhënë këtu në sallë
7 ndërkohë.

8 DËSHMITARI: Në rregull.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk besoj se më
11 ka mbetur më shumë se gjysmë ore pyetje pas pushimit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
13 për informacionin.

14 Do të bëjmë ndërprerjen këtu. Do të rimblidhemi në orën
15 11.30.

16 --- Pauza fillon në orën 11.00

17 --- Seanca rifillon në orën 11.30

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente,
19 sillni dëshmitarin në sallë.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
22 Dëshmitar, do të vijojmë tani me kundërpjetet nga ana e z.
23 Ellis.

24 Z. Ellis, vazhdoni.

25 Z. ELLIS: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, para pushimit po flisnim për librin tuaj, kam
2 dhe disa pyetje të mëtutjeshme për profesor Dacin.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Do lutesha të shfaqej në ekran
4 materiali DJK00725, edhe përkthimi në gjuhën angleze.

5 PY. Dëshmitar, a është e vërtetë që Armend Daci, që ishte
6 djali i profesor Dacit, është vrarë nga regjimi serb në 1996,
7 apo jo?

8 PË. E saktë.

9 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, çfarë relevance ka të
10 përmendet këtu djali i një redaktori të një libri?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë lidhje
12 ka kjo?

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Dua ta lidh me parathënien që ka
14 bërë z. Daci.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
16 relevancë, ju lutem. Kaloni në një pyetje tjetër.

17 Z. ELLIS: [Përkthim]

18 PY. Profesor Daci ishte nga Deçani apo jo?

19 PË. Saktë.

20 PY. Nuk ka qenë pjesë e UÇK-së në zonën e Nerodimës, apo jo?

21 PË. Nuk ka qenë.

22 PY. Pra, ai nuk e dinte nëse përmbajtja e librit tuaj ishte e
23 saktë apo kishte zbulime në të, kështu?

24 PË. Nuk e ka. Ai u bazu me atë çka unë kam paraqitur. A kjo
25 është e qartë që regjimi serb ia ka vra djalin, qysh m'i ka

1 vra edhe mu dy vëllezërit e mi në shtëpi. Njëri në shtëpi,
2 njëri në burg të Dubravës, kur dihet se të burgosurit kanë
3 qenë, duhet me, kanë qenë të mbrojtur me konventat
4 ndërkombëtare, por Serbia, okupatori nuk i ka respektu këto
5 konventa.

6 PY. Profesor Daci ishte pjesë e PDK-së apo jo, të njëjtës
7 parti ku ishit ju në 2012, kështu?

8 PË. Saktë.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Mirë, po vazhdoj. Mund të hiqet
10 prova materiale nga ekrani.

11 PY. Në librin tuaj, ju keni përfshirë edhe disa referenca të
12 një libri të Jakup Krasniqit, "Kthesa e madhe", ju kujtohet
13 kjo?

14 PË. Më kujtohet, por në detaje, jo.

15 PY. Por ju nuk i keni diskutuar asnjëherë ato pjesë të librit
16 me vetë z. Krasniqi, apo jo?

17 PË. Asnjëherë nuk e kam taku pasi e ka botu atë libër.

18 PY. Dhe ju e keni bazuar këtë pjesë të librit për rregulloret
19 e përkohshme të UÇK-së, e keni bazuar në librin e z. Krasniqi,
20 apo jo?

21 PË. Ka mundësi që e kam bazu, por e kam thanë edhe më herët
22 jam mundu që ta paraqes sa ma shumë t'i jap vlerë librit edhe
23 ta, që të pranohet libri sa ma shumë. Por rregullore --

24 PY. Drejt.

25 PË. Por rregullore nuk kam parë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 54

1 PY. Pyetja ime e radhës, pra. Ju me sytë tuaj nuk keni parë
2 rregullore të përkohshme. Në njësitin e Kaçanikut apo në
3 Brigadën 162 në 1998 ose në 1999, kështu?

4 PË. Nuk kam parë.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të vendosni në ekran provën
6 materiale P8, faqja 24? Faqja 24 edhe shqipja edhe anglishtja
7 më duket se e kanë të njëjtin numër. Faqja 24, ju lutem.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] 16 faqe ka dokumenti,
9 shqipja ka 17.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Më falni, më duket se faqja 14. Ju
11 kërkoj ndjesë, kisha parë numrin në fund të faqeve.

12 PY. Dëshmitar, e shihni pikën 11 në të majtë të ekranit, pika
13 11?

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta rrisim dhe më shumë.

15 PY. E shihni, këtu ku thuhet:

16 "Ushtarët e rregullt duhet të jenë të rruar, të qethur
17 dhe ushtarët rezervë..."?

18 E shihni?

19 PË. Po.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë tek një faqe e librit tuaj.
22 Që ka numrin 036622 dhe faqja 036800. Është një fotografi,
23 besoj që vetëm një imazh mjafton këtu. Shkojmë pak më poshtë.

24 PY. Shohim fotografinë, ju lutem, Dëshmitar, shohim
25 fotografinë këtu që është në të majtë. Këta janë luftëtarë të

1 UÇK-së në zonën e Nerodimës, në gusht 1998, kështu?

2 PË. E saktë.

3 PY. E shohim qartë disa prej tyre kanë mjekra, kanë flokë të
4 gjatë, apo jo?

5 PË. Po. Në mes jam unë.

6 PY. Pra, s'është respektuar rregullorja në njësitin tuaj,
7 kështu?

8 PË. Kjo dëshmon që s'e kam pa atë rregullore.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim dhe një herë rregulloren.

11 Ishte prova materiale P8. Në të njëjtën faqe.

12 PY. Shihni këtu ku thuhet, "Rregullat e shërbimit të
13 ushqimit", pika 9. E shihni këtu te pika 2 thuhet:

14 "Ushtarëve do t'u sigurohen tri vakte të ngrohta në
15 ditë."

16 Pika 3:

17 "Gjella para se të ndahet duhet të kontrollohet nga mjeku
18 ose infermieri, dhe oficeri i rojës të cilët duhet të lënë
19 shënime për kualitetin e ushqimit".

20 Dëshmitar, as kjo pjesë e rregullores nuk është zbatuar
21 në brigadën tuaj, apo jo?

22 PË. Absolut jo. Kur e thamë edhe në seancën paraprake se në
23 çfarë kushte është zhvillu lufta në pjesë të Kaçanikut.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund ta hiqni provën materiale nga

1 ekrani.

2 PY. Përveç rregulloreve provizore, që ju thoni i keni lexuar
3 në librin e z. Krasniqi, ju s'keni pasur dijeni të ketë pas
4 ndonjë rregullore tjetër me shkrim në UÇK, apo jo?

5 PË. Nuk kam pas njohuri.

6 PY. Të kishit pasur dijeni do t'i kishit përfshirë në librin
7 tuaj, apo jo?

8 PË. Normal.

9 PY. Flasim për një temë tjetër. Ju bëri, ju bënë disa pyetje
10 për marrëdhënien me LDK-në në Kaçanik. A është e vërtetë që në
11 Kaçanik UÇK-ja [Sipas përkthimit] i ka përkrahur përpjekjet
12 tuaja me çdo gjë që kishin, apo jo?

13 PË. Edhe një herë ju lutem pyetjen se...

14 PY. Po. Do ta bëj ndryshe pyetjen në fakt. I keni thënë diçka
15 Prokurorisë, është në pjesën 10 faqja 18, rreshtat 16 deri 18.
16 Ju keni thënë:

17 "Do të thoja që LDK-ja e Rugovës në Kaçanik na kanë
18 mbështetur me çdo gjë që kishin. Na kanë përkrah ose
19 mbështetur me çdo gjë që kishin."

20 PË. Absolut. Unë vetë e kisha thënë jo LDK-ja e Rugovës, por
21 LDK-ja e Kosovës. Se një kohë ka qenë si lëvizje e
22 përgjithshme popullore dhe në Kaçanik i gjithë populli
23 shqiptar e ka përkrah luftën çlirimtare.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Do doja t'ju tregoja dokumentin që
25 mban numrin DJK00644 deri në DJK00646. Faqja e fundit. Më

1 intereson numri 13.

2 PY. Dëshmitar, ky duket që është një dokument në pamje të
3 parë që ka renditur mbështetjen nga Ministria e Mbrojtjes.
4 Mbështetjen financiare. Më intereson pika 13 ku thuhet:

5 "Për nevoja të nënzonës së Kaçanikut i tërhoqi Xhafer
6 Shaqir Zharku..." dhe shumën përkatëse.

7 E shihni këtë?

8 PË. Po.

9 PY. Xhafer Sharku, a ka qenë anëtar i shtabit tuaj në
10 Kaçanik? I njësisë suaj në Kaçanik?

11 PË. Anëtar i shtabit të brigadës nuk ka qenë, por pjesëtar i
12 brigadës ka qenë.

13 PY. Dhe ky dokument përputhet me atë që keni thënë ju për
14 faktin që LDK-ja e ka mbështetur UÇK-në në zonën tuaj, kështu?

15 PË. Edhe pse ky dokument për mu është i panjohur, se nuk e
16 kam pas asnjëherë, as nuk e kam pas këtë njohuri, por me
17 siguri dikund e keni marrë ju.

18 PY. Vazhdojmë tek një dokument që e keni parë. Është nga
19 libri juaj me numër 044174 në faqen 044181.

20 Ky dokument ua ka treguar Prokuroria ditën e martë në mos
21 gaboj. Edhe duket që është një dokument i 27 majit 1999, këtë
22 datë mban, kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Që i takon të jetë pas vdekjes së Qamil Ilazit, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe emri në fund të dokumentit është Shukri Buja, kështu?

2 PË. Saktë.

3 PY. Dhe në rreshtin më sipër thuhet:

4 "Personi për zbatimin e kësaj urdhërese ngarkohet
5 ushtruesi i detyrës së komandantit së Brigadës 162 'Agim
6 Bajrami', z. Hajrush Kurtaj".

7 E shihni?

8 PË. Po.

9 PY. Nëse ishit emëruar zyrtarisht si komandant brigade,
10 Shukri Buja nuk do thoshte këtu ushtruesi i detyrës, do të
11 thoshte thjesht komandant të brigadës, apo jo?

12 PË. Sigurisht.

13 PY. Por, në përpyekjet për të vijuar luftën, ju vazhduat me
14 rolin tuaj edhe pas rënies së komandantit tuaj, Qamil Ilazit,
15 kështu?

16 PË. Ajo ishte e kuptueshme se isha zëvendëskomandant, njeri i
17 dytë mbas komandant Qamilit dhe kam pas obligim ta vazhdoj
18 luftën.

19 PY. Faleminderit.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të hiqet dokumenti nga ekrani.

21 PY. Do të flasim dhe për temën e fundit bashkë, Dëshmitar, që
22 ka të bëjë me situatën e pranverës dhe verës së 1999.

23 UÇK-ja u sulmua në zonën tuaj më 26 shkurt të 1999, te
24 Puset e Nikës, kështu?

25 PË. E saktë.

1 PY. Dhe u bë dhe një sulm tjetër në Gajre, më 28 shkurt të
2 1998 [Sipas përkthimit], kështu?

3 PË. Saktë.

4 PY. Dhe në Ivajë më 8 mars të 1999, kështu?

5 PË. E saktë.

6 PY. Këto sulme e ndikuan njësitin tuaj sepse njerëzit filluan
7 të shpërndareshin, kështu?

8 PË. E saktë, për shkak të forcave jo të barabarta, forca
9 shumë të mëdha të, forcat e okupatorit kanë qenë edhe, kanë
10 pas forca të shumta, por edhe me teknikë luftarake kanë qenë
11 ma të forta.

12 PY. Këto sulme kundër jush dhe civilëve vazhduan apo më saktë
13 u kryen gjatë kohës që ju ishit komandant në detyrë i
14 brigadës, apo jo?

15 PË. Po përfundimi i luftës ka ndodhë në momentin kur kam qenë
16 unë në detyrë të komandantit.

17 PY. Në rregull. Gjatë majit dhe qershorit të 1999, u
18 zhvendosën shumë civilë të cilët po largoheshin nga shtëpitë e
19 tyre dhe po shkonin drejt kufirit me Maqedoninë dhe kalonin
20 përmes zonës së Kaçanikut, kështu?

21 PË. E saktë. Ka edhe numra, vetëm nga komuna e Kaçanik mbi
22 40 000 banorë janë shpërngulur me dhunë nga shtëpitë e tyre
23 dhe janë deportu nga forcat serbe për në Maqedoni. Në mesin e
24 tyre mbi 200 qytetarë të Kaçanikut janë vra.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të vendosni në ekran një

1 video ju lutem, ka numrin DJK00724. Do shohim një pjesë shumë
2 të shkurtër të kësaj video, tek 0:45, fillon në 0:45.

3 [Luhet videoincizimi]

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të ndaloni këtu.

5 PY. Dëshmitar, me sa ju kujtohet ju, a ka qenë kështu situata
6 me civilët në zonën përreth Gajres në regjionin e Kaçanikut në
7 atë kohë?

8 PË. Sigurisht, mes Ivajës dhe Gajres. Pikërisht janë banorët
9 e Ivajës dhe Gajres që janë shpërngul me dhunë nga forcat
10 okupatore serbe.

11 PY. Dua të flasim dhe për situatën në Kosovë menjëherë pas
12 çlirimit. Ju i thatë Prokurorisë që 90 për qind e shtëpive në
13 zonën tuaj u dogjën, kështu?

14 PË. E saktë.

15 PY. Kur hytë ju në Kaçanik në 12 qershor 1999, kjo u incizua
16 nga Shefqet Pallusha, kështu?

17 PË. Këtë që e kemi në ekranin nuk është incizim i Shefqet
18 Palloshit. Kjo është i agjencionit AP. A pjesë të shkatërrimit
19 mbas lufte, është e vërtetë që i ka incizua Shefqet Palloshi. A
20 kjo çka e kemi në ekran nuk është incizim i Shefqet Palloshit.

21 PY. Këtë e kemi të qartë, por do ju tregoj një video tjetër
22 prandaj e thashë këtë, i parapriva. Është videoja DJK00722.

23 Z. PACE: [Përkthim] Para se të shfaqet videoja, a mund të
24 na shpjegojë avokati çfarë relevance kanë pyetjet që po i bën
25 dëshmitarit lidhur me këto video?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, relevanca është kjo. Krime
2 kundër të akuzuarve në periudhë të fundit të konfliktit në
3 këtë kohë kur situata, ne themi, situata ka qenë kaotike,
4 civilët po ktheheshin në shtëpitë që u ishin djegur, dhe do
5 shohim në një çast, dhe civilë që shprehin dëshirën për të
6 marrë hak kundër personave që kishin bërë këtë. Kjo ishte
7 pista ime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni me
9 pyetjet tuaja, kundërshtimi i Prokurori rrëzohet.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Thashë gjysmë ore, i nderuar
11 Gjykatës, nuk do ta zgjas më shumë. Edhe një herë bëhet fjalë
12 për materialin DJK00722. Ju lutem, filloni në sekondën e 20.
13 Faleminderit.

14 [Luhet videoincizimi]

15 "Z. Komandant, mirë se vini në Kaçanikun e lirë.

16 "Mirë se ju gjeta".

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Ndaloni këtu.

18 PY. A njohë ndonjë në këtë video që sapo pamë?

19 PË. Po, veten e njoha. Isha edhe unë në mesin e këtyre
20 bashkëluftëtarëve. Kjo ka qenë më 12 qershor kur kemi hi në
21 qytetin e Kaçanikut në orët e hershme të mëngjesit, në 04.49,
22 që është edhe në kamerë.

23 PY. Dhe disa nga luftëtarët janë me uniforma, ca me gjysmë
24 uniforma, ca janë me tesha civile, kështu?

25 PË. Po ato kanë qenë rrethanat, kushtet, që nuk kanë pas

1 mundësi të gjithë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me
2 qenë të veshun. Por edhe dëshira ka qenë e gjithë popullit t'i
3 bashkëngjitet Ushtrisë Çlirimtare.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Vazhdojmë, të shohim dhe pak nga
5 videoja, ju lutem.

6 [Luhet videoincizimi]

7 "Tash do t'i shiqojmë të gjitha barbaritë e shkaut. [E
8 padëgjueshme]

9 "Këtu jam zotëri.

10 "A ke andërru ndonjëherë?

11 "Jo vallahi, për ma vonë po.

12 "Ja pozicionet e shkive ku kanë pas, këtu, te stacioni i
13 autobusit. Ja se çfarë kanë bërë: Shkatërrim. Veç shkatërrim."

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj se mund ta ndalojmë këtu.

15 PY. Dëshmitar, kjo që patë në video a tregonte tamam siç
16 ishte situata kur u kthyet ju në Kaçanik më 12 qershor në
17 1999, shkatërrimi që i ishte bërë vendit?

18 PË. Origjinal shkatërrimi, 100 për qind, të gjitha këto ishin
19 shkatërrime të bizneseve që i kanë pas qytetarët e Kaçanikut.
20 Këto shkatërrime i kanë bo forcat kriminale serbe.

21 PY. Në kohën e çlirimit, kishte shumë civilë që jetonin në
22 Maqedoni, apo jo? Në kampe refugjatësh?

23 PË. E thashë, shumica e qytetarëve të Kosovës, por saktë e
24 thamë, vetëm nga Kaçaniku mbi 40 000 qytetarë janë detyru me
25 forcë të largohen për në Maqedoni.

1 PY. Pasi përfundoi konflikti dhe hyri KFOR-i, refugjatët
2 vërshuan drejt Kosovës sërish për të shkuar në banesat e tyre,
3 apo jo? Në shtëpitë e tyre?

4 PË. Sigurisht, ditët e para të çlirimit ka fillu kthimi i
5 gjithë qytetarëve dhe ne jemi përkujdes t'jua krijojmë kushtet
6 që sidomos në ato pjesë ku kanë qenë, ku i kanë minu forcat
7 serbe. Se kemi raste që edhe fëmija kanë pësuar nga minat që i
8 kanë vendos forcat okupatore serbe dhe jemi angazhu që t'i, të
9 kthehet, t'i kthejmë të gjithë qytetarët nëpër shtëpitë e tyre
10 në siguri me atë mundësi sa kanë qenë.

11 PY. Dhe pamë edhe pikat e kalimit kufitar në hartë pak më
12 herët. Është e vërtetë që refugjatët që po vinin nga Maqedonia
13 duhet me domosdoshmëri të kalonin përmes zonës tuaj në Kaçanik
14 për të shkuar në shtëpitë e tyre në Kaçanik, por dhe në pjesë
15 të tjera të Kosovës, kështu?

16 PË. E vërtetë.

17 PY. Dhe duke marrë parasysh numrin e refugjatëve në atë zonë,
18 situata ishte krejt kaotike, apo jo?

19 PË. Ka qenë shumë e rëndë dhe e pakontrollueshme për shkak se
20 dihet që në atë kohë edhe popullata është kthyer me shumicë
21 menjëherë edhe është kanë faza kur forcat e KFOR-it kanë fillu
22 me depërtu. Administratë tjetër nuk ka pas, kështu që gjendja
23 ka qenë shumë e randë.

24 PY. Shumë raste, fatkeqësisht, civilët kur u kthyen në
25 shtëpitë e tyre, siç e pamë dhe në video, konstatuan që

1 shtëpitë u ishin djegur, apo jo?

2 PË. E saktë.

3 PY. Do t'ju tregoj dhe një video të fundit. Ka numrin

4 DJK00723.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Tek sekonda e 10, ju lutem. Tek
6 minuta 1, sekonda 50, dhe ta vazhdojë për 10 sekonda videon.

7 [Luhet videoincizimi]

8 "Po këtu ça po mendoja, po si ma ka ba temen kështu a?
9 Kam [E padëgjueshme] bo rrafsh krejt. Se [E padëgjueshme] bo
10 kështu.

11 "Unë ku me ndejtë? Edhe ajo [E padëgjueshme]."

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Të ndalojmë këtu, ju lutem.

13 PY. Dëshmitar, keni dëgjuar civilë asokohe që të kenë
14 shprehur mendime të tilla kur janë kthyer dhe i kanë parë që
15 shtëpitë i kishin të djegura në zonën ku ju vepronit?

16 PË. Sigurisht. Të gjithë kanë qenë të dëshpërumë, se përveç
17 shkatërrimit të shtëpive, banesave, i kanë humb edhe të
18 afërmit e tyre. Mbi 200 qytetarë të Kaçanikut.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

21 Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të pranohen në provat
22 materiale pjesët e nxjerra nga tre videot që sapo pamë.

23 Z. PACE: [Përkthim] Kemi kundërshtim vetëm për pranimin e
24 videos së fundit, kjo që është tani në ekran. Nuk dimë fare
25 kush është kjo, ku është, kur është bërë kjo video. Dhe duket

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 65

1 se përgjigjja e dëshmitarit nuk lidhet me rrethanat e vetë
2 videos. Për dy të tjerat nuk kemi kundërshtim.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
4 numër DJK00724 pranohet. Materiali DJK00722 pranohet dhe
5 materiali DJK00723, edhe pse është me vlerë shumë të kufizuar,
6 do të pranohet, sepse ka lidhje me çështjen e hakmarrjes.

7 Z. Pace, kemi pyetje plotësuese?

8 Ah, jo, më falni.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 videoja me numër ERN-je DJK00724 deri në DJK00724 do të marrë
11 numrin e provës materiale me numër 4D00031. Me klasifikim
12 publik.

13 Videoja tjetër me numër ERN-je DJK00722 deri në DJK00722,
14 me transkriptin si në shqip dhe në anglisht -- mund ta
15 sqarojmë?

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk shoh arsye pse të mos jetë
17 publik.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Edhe videoja e dytë ka
19 transkript në anglisht dhe në shqip.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
21 Riklasifikojeni si publike.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Videoja e tretë me
23 numër ERN0-je DJK00723 deri në DJK00723, në transkriptin në
24 shqip dhe në anglisht do të marrë numrin e provës materiale
25 4D00033.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Pace

Faqe 66

1 Nuk e përmenda dhe numrin e provës materiale për videon e
2 dytë DJK00722, që merr numrin e provës materiale 4D00032.

3 Dhe pjesët e luajtura do të marrin shënimin përkatës në
4 *Legal Workflow*.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
6 Z. Pace, e keni fjalën.

7 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

8 Znj. Sekretare, ju lutem nxirrni në ekran një faqe që
9 pamë pak më përpara nga libri i dëshmitarit, me numër 06632
10 [Sipas përkthimit] deri në 06637 [Sipas përkthimit] që është
11 pamja me fotografinë përkatëse majtas lart. Po, kjo është.
12 Faleminderit.

13 Pyetje vijuese nga z. Pace:

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, gjatë pyetjeve pak më përpara që jua bëri
16 Avokati i Mbrojtjes ju konfirmuat që personat në këtë
17 fotografi që është nxjerrë nga libri juaj, ishin ushtarë të
18 UÇK-së në zonën e Nerodimës në gusht të 1998, dhe ju
19 gjithashtu thatë që ju jeni personi në mes.

20 Z. PACE: [Përkthim] Është në faqen 52, rreshtat 14 deri
21 në 23.

22 PY. Dëshmitar, njihni ndokënd tjetër në këtë fotografi, veç
23 vetes tuaj?

24 PË. Me emra nuk i di të jetë, unë jam, edhe komandanti Qamil
25 Ilazi që e njoh me emër. Të tjerët nuk i njoh me emra.

1 PY. Mund të bëni të ditur me përshkrim se cili, pra, mund të
2 na tregoni se cili nga personat në fotografi është Qamil
3 Ilazi?

4 PË. Qamil Ilazi është ky. Ky jam unë. Të tjerët janë
5 bashkëluftëtarë të tonë, por me emra nuk i di.

6 PY. Shoh që e keni shënuar dokumentin me lapsin. Për të qenë
7 të qartë ju jeni i qarkuar me rrethin majtas, Qamil Ilazi
8 është i qarkuar me rrethin djathtas?

9 PË. Po.

10 PY. Personat e tjerë dhe pse nuk ju kujtohen emrat, ju
11 kujtohet se në ç'njësit a ç'batalion bënë pjesë?

12 PË. Nuk më kujtohet.

13 PY. E njihni vendin ku ndodhëni këtu?

14 PË. Po. Është në fushën e Jezercit.

15 PY. A ju kujtohet rasti, me ç'rast ndodhësit në fushën e
16 Jezercit në gusht 1998?

17 PË. Kjo është një ndenje e lirë dhe një fotografi me
18 bashkëluftëtarë.

19 PY. Mund t'u thoni Gjykatësve se ç'armë ka këtu në këtë
20 fotografi?

21 PË. Pushkë automatike.

22 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
23 pranohet versioni i këtij, i kësaj fotografie, siç është
24 shënuar nga dëshmitari.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Pace

Faqe 68

1 kundërshtim. Kështu që 066322 dhe në P0368 [Sipas përkthimit]
2 pranohet dhe shënohet.

3 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të sqaroj,
4 dëshiroj që ky version të ruhet siç është shënuar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 shënimet që ka bërë dëshmitari në -- dëshmitari W04576 në
8 provën me numër ERN 036800 do të ruhen me numrin e Zyrës
9 Administrative REG01171 dhe do të caktohet numri i provës
10 materiale P01019.

11 Z. PACE: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, pak më herët më përpara, dhe në transkript
13 është në faqen 38, rreshtat 15 deri 17, ju është bërë kjo
14 pyetje dhe ju keni dhënë këtë përgjigje, po i lexoj:

15 "PY. Tani, Dëshmitar, asokohe komunikimet me telefon
16 ishin të rralla, apo jo? Për shkak të problemeve me sigurinë.

17 "PË. Të rralla. Dhe lirisht mund të them se nuk ka pasur
18 të tilla.

19 Dëshmitar, pyetjen për ju e kam kështu. Po thoni që
20 askush, asnjë anëtar i Brigadës 162 nuk kishte një telefon
21 mobil në vitin 1998 apo 1999 që ta përdorte?

22 PY. Kur e flas, e flas atë për vete që nuk kam pas dhe të
23 tjera nuk kam parë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem nxirrni në
25 ekran materialin me numër 018655-01, është një video që e kemi

1 në listën e materialeve të ZPS-së. Do të doja që të shohim pa
2 zë, minutat nga fillimi, pra, deri në -- pra që nga fillimi
3 deri në 29 sekondat e para. Mund të transmetohet publikisht.

4 Pra, për të shpjeguar.

5 PY. Dëshmitar, pikë së pari, e shikoni videon në ekran?

6 PË. Nuk po shihet mirë.

7 PY. Të shohim 29 sekondat e para të kësaj videoje, nuk ka
8 nevojë për zë. Ju lutem, ndiqeni me vëmendje se kam nja dy
9 pyetje më mbrapa.

10 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem.

11 [Luhet videoincizimi]

12 DËSHMITARI: Nuk është telefon i imi. Është marrë nga një
13 qytetar për me fol me familje. Edhe aty nga incizimi shihet që
14 folin me familjen.

15 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Pra, tek 29 sekondat e
16 para, e ndalojmë.

17 PY. Dëshmitar, nëse kuptoj saktë thatë se nuk është telefoni
18 juaj. Është telefon që është marrë prej njërit prej qytetarëve
19 që ata të flisnin me familjarët. Kush janë në këtë, kush është
20 në, kush janë këta tre personat që pamë në këto 29 sekonda, ju
21 lutem?

22 PË. Njëri jam unë, njëri është dëshmori i kombit, Nehat Caka,
23 dhe tjetri është bashkëluftëtari im që është plagos më 9 prill
24 1999, Rustem Demaj.

25 PY. Dhe juve, Rustem Demaj, Nehat Caka, ishit të tre anëtarë

1 të UÇK-së, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Mund t'u thoni Gjykatësve, të sqaronit, se ç'po bënit me
4 këtë telefon? Ia morët një civil për të bërë çfarë?

5 PË. Ia morëm një mikut civil për me fol me familjet tona që
6 me ditë a kanë mujtë me kalu kufirin për në Maqedoni. Edhe
7 gjatë incizimit mundeni, muj edhe Gjykata, edhe të gjithë me
8 vërtetu kur flasim me familje.

9 PY. Po, mundet ta luajmë edhe me zë, pa problem.

10 [Luhet videoincizimi]

11 Z. PACE: [Përkthim] Unë për vete nuk dëgjova gjë, nuk e
12 di për të tjerët.

13 [Anëtarët e Trupit Gjykues dhe Sekretarja e
14 Gjykatës këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duket që
16 video është pa zë.

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 PY. Për fat të keq, nuk ka zë videoja, Dëshmitar. Për fat të
19 keq, nuk e dëgjojmë dot. Por të sqaroj, këtë telefon që e
20 shohim këtu, ju thatë e keni marrë prej civilëve. Pra, po
21 thoni që anëtarët e UÇK-së të Brigadës 162 s'e kishin
22 asnjëherë një celular me e përdor në një moment apo një tjetër
23 gjatë 1998-1999?

24 PË. Nuk kemi pasun edhe për shkak të sigurisë që e kam thanë
25 edhe ma herët, për shkak të sigurisë. Edhe nuk kemi pas, por

1 edhe nuk kemi tentu që të përdorim dhe t'i kemi përveç për
2 nevojat familjare.

3 PY. A ju kujtohet gjatë seancës përgatitore që bëmë para pak
4 javësh që i thatë Prokurorisë që njerëzit morën celular,
5 telefonat celularë, pas marsit, pas 8 marsit, a 24 marsit?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi të njëjtin kundërshtim si më
7 përpara që po diskreditohet dëshmitari pa lejen e Trupit
8 Gjykues.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ajo është
10 thjesht një pyetje që i bëhet këtu, s'është se po i tregon
11 ndonjë gjë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, a po i referohet një takimi
13 specifik që ma merr mendja ka dhe një dokument, se janë
14 shënime përgatitore. Nuk e di nëse e konsideron apo jo
15 shënimin përgatitor si deklaratë dhe mbase mund të
16 konsiderohet si deklaratë në funksion të rregullës 143. Por
17 duket se përdoret për diskreditimin pa lejen e Trupit Gjykues.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
19 kundërshtimi.

20 Z. PACE: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, ju kujtohet besoj që para pak javësh kur folëm
22 në seancën përgatitore në Prokurori, që ju thatë se njerëzve
23 iu dhanë celularë pas 8 marsit 1999, mbase mbas 24 marsit
24 1999?

25 PË. Nuk e kam të qartë këtë. Cilët njerëzve, kush jua ka

1 dhanë ato telefona, edhe cilët njerëzve jua kanë dhanë, kur në
2 kohë lufte nuk kemi pas mundësi as ne t'i kemi, por as
3 qytetarët, se janë detyru të largohen edhe nga shtëpitë e
4 tyre.

5 PY. Dëshmitar, mund të sqaroni që thatë që edhe vetë për
6 civilët nuk mundet, por pak më përpara ju thatë që këtë
7 telefon ia kishit marrë civilëve. Mund ta shpjegoni si është?

8 PË. Ju lutem, e kishim huazu nga një mik të bisedojmë me
9 familjet tona që forcat serbe i kishin deportu me dhunë nga
10 shtëpitë e tyre. Edhe unë nuk e kam qartë që aq fort po ju
11 intereson edhe komunikimi jonë me familjen, me anëtarët e
12 familjes, në ato rrethana të vështira. Vërtet nuk e kam të
13 qartë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, kjo
15 ka shumë pak rëndësi për Trupin Gjykses. Sugjeroj të kaloni në
16 një pyetje tjetër.

17 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera, i nderuar
18 Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
20 fillojmë me disa pyetje. Gjykatësi Mettraux do të fillojë me
21 pyetjet nga Trupi Gjykses.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës
23 Smith.

24 Pyetje nga Trupi Gjykses:

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

1 PË. Mirëdita.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të
3 nxjerrë dokumentin me 07300 [Sipas përkthimit].

4 Kam ca pyetje të shkurtra për këtë dokument. Pikësëpari,
5 a mund të konfirmoni, z. Dëshmitar, se kjo është një farë
6 biografie, të themi, që e keni përgatitur ju vetë?

7 PË. Një biografi e shkurtër e imja, po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe përmbajtja e kësaj
9 biografie me aq sa thoni ju është e saktë, apo jo?

10 PË. E saktë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe siç thotë këtu, jeni
12 kyçur në UÇK më 1 qershor të 1999, kështu?

13 PË. Po.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni, z. Gjykatës, besoj e
15 kishit fjalën për 1998, apo jo?

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Misetic.
17 E kisha fjalën 1 qershor 1998, apo jo?

18 PË. E saktë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe këtu thuhet se ishit
20 anëtar i UÇK-së deri në 19 shtator të 1999, kështu?

21 PË. E saktë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dje thatë, dhe po citoj
23 këtu nga transkripti faqen 108, jo dje madje, ditën përpara.
24 pardje. Thatë që:

25 "Zona e Nerodimës e UÇK-së e përfundoi misionin më 19

1 shtator të 1999".

2 Ju kujtohet që keni thënë kështu?

3 PË. Ka ndodh në këtë datë, ka ndodh transformimi i Ushtrisë
4 Çlirimtare të Kosovës në Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, kjo do të thotë se
6 jeni demobilizuar nga UÇK-ja atë datë, më 19 shtator të 1999,
7 kështu është?

8 PË. E saktë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju pyes tani për një
10 sërë individësh që kanë rëndësi për këtë çështje gjyqësore.
11 Dhe do t'ju kërkoj që të jeni sa më i saktë dhe sa më shkurt
12 të flisni në përgjigjet tuaja.

13 Në intervistën që i keni dhënë ZPS-së, keni konfirmuar se
14 Rrustem Demaj, Nuhi Provoliu dhe Bujar Tafili, ishin të gjithë
15 anëtarë të togut të udhëhequr nga Xhabir Elezi. Ju kujtohet që
16 e keni thënë kështu?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe i qëndroni që edhe
19 kësaj -- i qëndroni dhe sot, domethënë, kësaj që keni thënë?

20 PË. Po, patjetër.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Xhabir Elezi ju thatë
22 ishte komandant i njësisë së policisë ushtarake në Kaçanik,
23 kështu?

24 PË. Kështu në bazë të atij dokumenti, por nuk ka qenë
25 kompetencë e imja. Ka qenë kompetencë e komandantit të

1 brigadës dhe unë nuk e kam vendos në atë detyrë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj, do të vijmë edhe
3 tek kompetencat pas pak. Tani dua që të më konfirmoni edhe se
4 siç del nga libri juaj që Xhabir Elezi ishte që më përpara
5 komandant i togut të policisë ushtarake që në shkurt, pra, të
6 1999, kështu?

7 PË. Del nga një dokument që vetëprezantohet ashtu, por
8 dokumenti nuk është i nënshkrumë, kështu që nuk muj me
9 konfirmu saktë. Se është dokument i panënshkrumë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. Por keni
11 përpiluar një tabelë një -- e cila mban datën shkurt dhe mars
12 të 1999, në të cilën ai paraqitet si komandanti i policisë
13 ushtarake. Kështu është apo jo?

14 PË. Po vetëm të jemi të qartë se nga një dokument i
15 panënshkruar.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nga libri juaj duket
17 se ai ishte ende komandant i policisë ushtarake edhe në
18 qershor të 1999, apo jo?

19 PË. Nuk jam i sigurt për këtë.

20 Z. TULLY: [Përkthim] Më falni, thjesht për të sqaruar për
21 transkriptin. Për cilën pjesë të librit po flasim? Thjesht që
22 ta kemi dhe ne parasysh për evidencat tona.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, edhe mund të shohim
24 drejt e në libër, mbase mund të ishte dhe më e lehtë. Është
25 036622. Është libri "Lufta e UÇK-së në ZON". Dhe më intereson

1 pyetja e fundit, pra, ka të bëjë me faqen 101 të vetë librit
2 me numër ERN-je 036718. Dhe mbase duhet ta jap edhe për
3 shqipen numrin përkatës. Është faqja 97 të versionit PDF,
4 numri ERN 077139. Është faqja 101 në shqip dhe 97 në anglisht,
5 në materialin në format PDF.

6 Pra, këtu kemi një diagramë të përgatitur prej jush e të
7 publikuar në librin tuaj, ku, pra që është "Komanda e Brigadës
8 162 'Agim Bajrami'" dhe në shkronja kursive më poshtë është
9 "Data 15 maj 1999, Kaçanik, te Kulla e Hasanit". Ju kujtohet
10 që e keni përgatitur vetë ju këtë diagram, zotëri?

11 PË. Është e vërtetë që e kam përgatitë, por po e përsëris
12 prapë, kjo ka qenë ashtu qysh kam pasë dëshirë e jo vërtet
13 qysh ka funksionu. Se nuk kemi pas mundësitë me funksionu bash
14 kështu. Edhe sot nuk ka mundësi forcat, tamam forcat në paqe,
15 të funksionojnë kështu qysh e kam paraqit unë në kohë lufte.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ajo që po ju pyes, po ju
17 kërkoj këtu, vetëm që të konfirmoni që më datën që ju e, që e
18 keni shkruar këtu, është që diagrami kështu tregon që kështu
19 kanë qenë punët, dhe komandanti i policia ushtarake ishte
20 Xhabir Elezi atëherë, kështu?

21 PË. Paramendoni në kohë lufte edhe një ditë mbasi ka ra
22 komandanti i brigadës, çfarë çrregullimi mund të ketë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, jo. Një moment, një
24 moment. Jo. Po ju pyes në këtë diagram, komandanti i policisë
25 ushtarake a është ende Xhabir Elezi apo jo? Më 15 maj të vitit

1 1999?

2 PË. Më 15 maj, po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A njihni dikënd, a dini,
4 pra, që ndonjë moment nga 1 qershori i 1998 kur jeni kyçur në
5 UÇK, e deri në qershor të 1999, ndonjë tjetër veç Xhabir
6 Elezit që të ketë qenë komandant i policisë ushtarake?

7 PË. Nuk kam njohuri rreth kësaj pyetje, por edhe nuk ka qenë
8 kompetencë e imja në 1998.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta përsëris pyetjen, a
10 keni dijeni, a dini nëse ndonjë person tjetër veç Xhabir
11 Elezit ta ketë pasur postin e komandantit të policisë
12 ushtarake të Brigadës 162, po ose jo?

13 PË. Jo.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, Xhabir Elezi si shef
15 i policisë i raportonte komandantit të brigadës, për këtë
16 pajtoheni, apo jo?

17 PË. Deri më 15 maj nuk e di, se nuk ka qenë kompetencë e
18 imja.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në intervistën me ZPS-në,
20 Pjesa 2, faqja 17, dhe do t'jua lexoj, ju është bërë pyetja:

21 "Xhabiri i raportonte komandantit të brigadës apo dikujt
22 tjetër?"

23 Dhe ju jeni përgjigjur:

24 "Komandantit të brigadës dhe vetëm komandantit të
25 brigadës."

1 I qëndroni kësaj përgjigje dhe sot apo doni që të
2 shprehni ndonjë rezervë për këtë?

3 PË. Me siguri e kam thënë, por asnji moment nuk muj me dëshmu
4 se unë kam qenë prezent kur i ka raportu komandantit të
5 brigadës.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po jua bëj ndryshe
7 pyetjen. Dini nëse Xhabir Elezi i ka raportuar dikujt tjetër
8 përveç komandantit të brigadës?

9 PË. Nuk kam njohuri.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju bëj pyetje për
11 tjetër person tani, nuk e di nëse është shqiptimi i duhur,
12 Fadil Kaka -- nuk e di a e kuptoni për kë e kam fjalën?

13 PË. Fadil Çaka.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, atëherë. E
15 njihni këtë person, Fadil Çakën?

16 PË. E njoh. Fadil Çaka ka ra në betejën e 9 prillit në
17 Kaçanik ku kanë ra 32 qytetarë të Kaçanikut që janë vra nga
18 forcat serbe dhe 28 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare që kanë ra
19 në mbrojtje të qytetarëve atë ditë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe ky, pra Fadil Çaka
21 ishte anëtar i njësisë së policisë ushtarake, kështu? I
22 Brigadës 162?

23 PË. I Brigadës 162, po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë intervistës me
25 ZPS-në ju thatë se një prej detyrave që kishte policia

1 ushtarake ishte që të siguronte që anëtarët e forcave të
2 respektonin rregulloren e disiplinës. Ju kujtohet që e keni
3 thënë këtë?

4 PË. Jo një nga detyrat, por e vetmja detyrë të cilën e kanë
5 pas, e kanë pas ata, për këtë detyrë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të vijmë pas pak te
7 kjo. Kjo është një prej detyrave. Por kjo a nuk do të thotë
8 që, që në shkurt të 1999, mos më përpara, ka pasur rregullore
9 disipline brenda UÇK-së, apo jo?

10 PË. Nuk ka pas për shkak se sulmi i parë ka ndodh edhe
11 veprimi i njësive të para ka ndodh më 26 shkurt 1999, kështu
12 që nuk, në atë kohë nuk ka pas.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, siç po më thoni tani,
14 nëse thoni që e vetmja detyrë e policisë ushtarake ishte që të
15 zbatoheshin rregullorja e disiplinës dhe nuk paska pasur
16 rregullore më 26 shkurt, përpara 26 shkurtit 1999, çfarë bënte
17 policia ushtarake përpara kësaj date?

18 PË. Nuk ka ekzistuar para kësaj date, absolut. Formimi i
19 njësive të para, njësive të organizime të para ka filluar
20 fillimi i marsit e ma tutje.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në atë rast do kthehem
22 pak tek libri juaj. Edhe një herë të shfaqet materiali me ERN
23 036622. Dhe kësaj here na nevojitet faqja 42, kjo është tek
24 anglishtja. Për një çast do ju jap edhe për shqipen. 03662
25 [Sipas përkthimit]. Faqja 41 në PDF-në në anglisht, dhe 42 në

1 shqip.

2 Në fakt shkojmë një faqe më përpara. Fillojmë tek faqja
3 më përpara. Me ERN 03661 [Sipas përkthimit] anglishtja dhe
4 077079 shqipja.

5 Dëshmitar, këtu thoni: "Anëtarët e, formacioni i shtabit
6 të komandës për Ferizajn në Jezercë", shkruhet këtu. Kjo ka
7 qenë struktura fillestare se si keni operuar ju, kështu?
8 PË. Unë e kam thanë në disa seanca dhe prapë e përsëris. Këtu
9 e kam paraqit ashtu qysh kam pas dëshirë e jo qysh ka qenë në
10 realitet.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë tek faqja tjetër
12 tani. Më pas kjo u bë njësia e Kaçanikut, kështu?

13 PË. Kur?

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po a pajtoheni apo nuk
15 pajtoheni kjo që ka qenë strukturë e ekzistonte në shkurt të
16 1999, kështu? Struktura ishte ekzistuese në shkurt të 1999?

17 PË. Ka vepru deri në fillim të, deri në fillim të marsit me
18 njësi të vogla të Kaçanikut.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përsëris pyetjen. A po e
20 kundërshtoni parashtrimin tim apo pajtoheni me parashtrimin
21 tim që ka qenë struktura, kjo ka qenë struktura e njësitit të
22 Kaçanikut në shkurt të 1999?

23 PË. Nuk ka qenë kjo... Tash për cilën strukturë po folim, a
24 për këtë në gjuhën angleze apo në gjuhën shqipe? Vetëm ta
25 definojmë. Se këtu në ekran i kam dy struktura të ndryshme.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shihni në shqip, shihni
2 atë në shqip që mund të lexoni dhe na thoni, a ka ndonjë gjë
3 në këtë formacion që e keni ju, strukturë, që në fakt nuk ka
4 ekzistuar në shkurt të 1999, që nuk ka qenë kështu siç është
5 këtu në diagram.

6 PË. Nuk ka qenë, kjo ka qenë një njësit që ka vepru, i
7 Kaçanikut, që ka vepru nga 4 gushti 1998 deri me 28 shtator
8 1999 në Jezercë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të jemi të qartë. Po thoni
10 tani që në shkurt të 1999 nuk ka pasur polici ushtarake në
11 Kaçanik? Apo po përpigëni të thoni diçka tjetër?

12 PË. Vetëm po e përsëris edhe një herë. Që kjo strukturë nuk
13 ka funksionu, qe kjo strukturë ka funksionu më njësitin e
14 Kaçanikut në Jezercë ato dy muaj që e kam thënë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po e përsëris pyetjen. Në
16 shkurt të vitit 1999, ka pasur apo nuk ka pasur njësi të
17 policisë ushtarake në Kaçanik, cila është dëshmia juaj?

18 PË. Nuk kam njohuri rreth saj se nuk ka qenë kompetencë e
19 imja.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Flasim për z. Fadil Caka.
21 A pajtoheni me mua që eprori i tij i drejtpërdrejtë edhe para
22 marsit të 1999, ka qenë po ashtu Xhabir Elezi, pajtoheni?

23 PË. Nuk jam i sigurt se nuk ka, strukturat janë kanë në
24 formim e sipër e nuk jam i sigurt që ka qenë e formume deri në
25 atë kohë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 82

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, gjatë intervistës me
2 ZPS-në, që është Pjesa 7, RED, faqja 7, ju keni thënë:

3 "Dhe para kësaj, në mars të 1999, kujt i raportonte Fadil
4 Çaka?", kjo ishte pyetja.

5 Përgjigjja juaj:

6 "Komandantit të togës së policisë ushtarake, Xhabir
7 Elezit".

8 Vazhdoni t'i qëndroni kësaj që keni thënë apo doni ta
9 ndryshoni?

10 PË. Nuk jam i sigurt për këtë se nuk ka qenë kompetencë e
11 imja.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Doni ta ndryshoni atë që i
13 keni thënë Prokurorisë?

14 PË. Nuk... e përsëris prapë, nuk kam njohuri të sakta për
15 shkak se nuk ka qenë kompetencë e imja në atë kohë.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, përgjigjja e pyetjes
17 sime është "Po, dua ta ndryshoj këtë që i kam thënë
18 Prokurorisë"?

19 PË. Sigurisht se po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në Pjesën 10 të
21 intervistës suaj, RED, ju bën pyetje sërish Prokurori:

22 "Kush ka qenë në pozita për të lëshuar urdhër për Fadil
23 Çakën?"

24 Përgjigjja juaj:

25 "Për sa kohë nuk e di a kishte dalë ndonjë urdhër, por

1 unë do të thoja që Fadil Çaka ka qenë pjesë e togës që e
2 drejtonte Xhabir Elezi", keni thënë ju.

3 Tani doni ta ndryshoni dhe këtë që keni thënë?

4 PË. Nuk jam i sigurt se edhe aty, e kam thanë se nuk jam i
5 sigurt për atë se nuk kam pas njohuri unë rreth funksionimit
6 të kësaj se nuk ka qenë kompetencë e zëvendëskomandantit.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni dijeni kujt i
8 raportonte tjetër Fadil Çaka, jeni në gjendje të na jepni
9 ndonjë emër kujt i raportonte Fadil Çaka përveç Xhabir Elezit?
10 PË. Nuk kam njohuri.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Xhabir Elezi si drejtuesi
12 i policisë, i togës së policisë ushtarake, i raportonte
13 drejtpërdrejt Qamil Ilazit, komandantit të brigadës, kështu?
14 PË. Mund të jetë e kuptueshme, por unë e përsëris prapë se
15 nuk ka qenë kjo kompetencë e imja. Unë kam qenë
16 zëvendëskomandant për operacionet luftarake. Kështu që me atë
17 është marrë komandanti i brigadës, Qamil Ilazi.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, e kuptoj. Por ju ishit
19 oficer ushtarak me përvojë, e pranoni ju që si rregull shefi i
20 policisë ushtarake i raportonte komandantit të brigadës, apo
21 thoni që nuk është kështu?

22 PË. Nuk kam njohuri, nuk jam, nuk kam njohuri të plota se
23 edhe nuk kam qenë oficer shumë me përvojë, se kam qenë
24 nënoficer edhe me shkollë të mesme. Kështu që detyrat e mia ma
25 së shumti kam mujt me i ditë deri në formacionet e, apo që më

1 kanë ngarku për përgatitjen e luftëtarëve, për armatim, front,
2 vijë të frontit. Kështu që nuk kam njohuri rreth shtabeve të
3 larta. E kam kry akademinë e mesme ushtarake.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në intervistën që i keni
5 dhënë Prokurorisë, Pjesa 7, RED, ju bëhet kjo pyetje, ju bëhet
6 pyetja për një incident konkret gjatë një luftimi dhe në
7 përgjithësi kujt i raportoj. Dhe është kështu, pyetje:

8 "Fadil Çaka i raportonte drejtpërdrejt Qamil Ilazit?"

9 Përgjigja juaj:

10 "Në atë rast po..."

11 Bëhet fjalë për një operacion konkret.

12 "... por ishte pjesë e strukturës së policisë ushtarake".

13 "PY. Pra në prill të 1999, ai i raportonte Qamil Ilazit"

14 "Deri në ato momente, sepse ai u vra gjatë luftimeve."

15 Pra, kur jua ka bërë këtë pyetje Prokuroria ju e keni

16 pohuar që Qamil Ilazi ishte personi të cilit i raportonte

17 Xhabir Elezi. Dhe pyetja ime është kjo, tani i qëndroni kësaj

18 deklaratë që keni dhënë apo dëshironi ta ndryshoni?

19 PË. Duhet një sqarim rreth kësaj deklaratë. Se në kohën, më 9

20 prill, kur është sulmu pjesa e qytetit, Përroi i Rakocit, dhe

21 Lagjja e Re, që janë vra 32 qytetarë të Kaçanikut dhe 28

22 luftëtarë në ato luftime --

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, jo, Dëshmitar. Nuk

24 është nevoja. Nuk është nevoja për sqarime të mëtutjeshme.

25 Thjesht përgjigjuni pyetjes sime.

1 Keni dhënë dëshmi për Prokurorinë. Dhe keni thënë që
2 Xhabir Elezi i raportonte Qamil Ilazit. Tani unë po ju bëj një
3 pyetje të thjeshtë tani, i qëndroni kësaj deklaratë, mendoni
4 pra, në të njëjtën formë, apo doni ta ndryshoni këtë?

5 PË. Mund të kem thënë, megjithatë prapë e përsëris.
6 Kompetencat e mia nuk kanë qenë me ditë se kujt, kush i
7 raporton. Unë kam pas detyrën time.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, i qëndroni apo s'i
9 qëndroni deklaratës që i keni dhënë Prokurorisë?
10 PË. Nuk i qëndroj.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë. Unë po ju parashtroj
12 këtë, dhe do shohim edhe deklaratën nëse është nevoja. Që
13 atëherë i bie që Qamil Ilazi ka qenë vartës i komandantit të
14 zonës, Shukri Bujës në atë kohë, kështu? E pranoni këtë?

15 PË. Edhe kjo s'ka qenë kompetencë e imja. Edhe nuk kam marrë
16 pjesë në asnjë takim dhe asnjëherë nuk më ka njoftu komandant
17 Qamil Ilazi se kujt i raporton.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë intervistës me
19 ZPS-në, Pjesa 2, faqja 11, ju keni thënë, citoj:

20 "Komandanti i brigadës i raportonte komandantit të
21 zonës."

22 Me fjalë të tjera, Qamil Ilazi i raportonte Shukri Bujës.
23 Mbyll citimin [Sipas përkthimit].

24 Dhe po ju bëj të njëjtën pyetje siç ju bëra më herët. I
25 qëndroni kësaj deklaratë apo dëshironi ta ndryshoni?

1 PË. Unë nuk muj me konfirmu një punë që nuk e kam parë, edhe
2 nuk kam marrë pjesë në ato asnjherë, kur komandant Bardhi i
3 ka raportu Shukri Bujës. Kështu që nuk muj, nuk mundem ta
4 konfirmoj një gjë që nuk ka qenë kompetencë e imja, që nuk e
5 kam parë unë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë, më thuaj këtë
7 atëherë. Kur ia keni thënë ZPS-së, kur dhatë intervistën, ku u
8 bazuat ju? Nëse nuk jeni bazuar në atë që dinit vetë, atëherë
9 ku u bazuat?

10 PË. Po nuk jam i sigurt në çka jam bazu.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. Sa i takon
12 raportimit, le të vijojmë me këtë pikë. A pajtoheni ju që nga
13 komandanti i zonës, si rregull, raportohet, në kushte normale,
14 tek shefi i shtabit, i raportohet shefit të Shtabit -- të
15 UÇK-së, kështu, pajtoheni me mua?

16 PË. Vetëm nuk po e di, tash po folim për kohë lufte apo kohë
17 normale? Koha e luftës është diçka tjetër. Në kohën e luftës
18 nuk e kam pas këtë informacion.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë jam i interesuar vetëm
20 për kohën e luftës. Për periudhën kur keni qenë anëtar i
21 UÇK-së --

22 PË. [Folës që flasin njëkohësisht]

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- nuk na interesojnë
24 periudhat e tjera. Ja, pyetja ime është kjo, duroni një çast.
25 Do ta thjeshtoj më tej. Në intervistën me ZPS-në, Pjesa 2,

1 faqja 14, ju bëjnë pyetje:

2 "Kujt i raportonte komandanti i zonës?"

3 Dhe ju keni filluar të përgjigjeni:

4 "Unë nuk kam qenë komandant zone në fakt, por normalisht
5 i raportonin shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Por komandanti
6 i zonës, nëse keni pas rast ta takoni, do t'ua thotë vetë këtë
7 gjë."

8 Pra, kur ia keni thënë këtë ZPS-së që normalisht,
9 normalisht, komandanti i zonës i raportonte shefit të Shtabit
10 të Përgjithshëm, ku u bazuat ju për ta thënë këtë, në qoftë se
11 nuk e kishit dijeni personale, mbi ç'baza e thatë?

12 PË. Nuk e kam pas këtë dijeni, vetëm unë, mund të ketë qenë
13 një supozim i imi që nuk muj me konfirmu se derisa nuk e di
14 saktë, nuk kam marrë pjesë, nuk muj me konfirmu që është
15 ashtu.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, jeni ushtarak me
17 përvojë. Shiheni nga perspektiva juaj. Z. Buja në librin tuaj
18 ka thënë kështu, dhe unë mund ta citoj nëse është nevoja, se
19 keni përdorur "njohuritë e tua të konsiderueshme në fushën
20 ushtarake", kështu ju ka përshkruar ai ju. A ka qenë i saktë
21 ky përshkrimi juaj? A keni pasur ju njohuri të konsiderueshme
22 ushtarake, apo e ka zmadhu e zbukuru z. Buja tani gjërat?

23 PË. Kam pas njohuri ushtarake të nivelit të akademisë së
24 mesme, shkollës së mesme. Sa është e nënkuptueshme, dihet deri
25 në çfarë njohuri me shkollë të mesme ushtarake mund të ketë

1 nji nënoficer.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, po jua bëj këtë
3 pyetje ju si ushtarak: Nëse nuk i raportonte Shtabit të
4 Përgjithshëm, sipas jush, kujt duhet t'i raportonte komandanti
5 i zonës?

6 PË. Në atë kohë nuk kam pas njohuri.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju ishit anëtar i UÇK-së
8 dhe nuk kishit njohuri se si ishte marrëdhënia mes komandantit
9 të zonës dhe Shtabit të Përgjithshëm, këtë po thoni në
10 dëshminë tuaj?

11 PË. Nuk kam pas njohuri se nuk kam mujt unë si zëvendës
12 komandant i brigadës ta di se çka ban komandanti i zonës apo
13 çfarë raporte ka me Shtabin e Përgjithshëm. Këto nuk kanë qenë
14 njohuritë as kompetencat e mia.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të tregojmë, të flasim se
16 si funksionon në praktikë dhe do ju kërkoj të më komentoni në
17 lidhje me këtë.

18 I lutem Zyrës Administrative të nxjerrë në ekran provën
19 materiale P887. Me të njëjtin numër është edhe shqip.

20 Dëshmitar, njihuni me tekstin përpara dhe na thoni kur ta
21 keni përfunduar së lexuari.

22 PË. Këtë dokument asnjëherë nuk kam pas mundësi ta shoh.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, kjo do të ishte pyetja
24 ime e parë në fakt. Atëherë, pyetja e dytë është kjo. E shohim
25 dokumentin me hollësi.

1 Titulli është "Sqarim". Data është ose më 17 ose 18
2 dhjetor i 1998. Sikurse mund ta shihni dhe ju vetë, ka numrin
3 06/01, vjen nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Shtabi i
4 Përgjithshëm, Drejtoria e Policisë Ushtarake. Titulli "Sqarime
5 këshilla për kryerjen e detyrave". Dhe i drejtohet komandantit
6 të kompanisë së policisë ushtarake të zonës operative të
7 Nerodimës. E shihni këtë?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim më tej në dokument,
10 kështu shohim që është bërë një kërkesë nga policia ushtarake,
11 pra nga komandanti i kompanisë së policisë ushtarake të zonës
12 operative të Nerodimës, më 15 dhjetor. Do ta shohim dhe për
13 cilin person bëhet fjalë. Dhe i drejtohet Drejtorisë së
14 Policisë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për
15 sqarime dhe këshilla. E shihni?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vazhdojmë më tej në
18 dokument, 1, thuhet:

19 "Në bazë të rregullores së policisë ushtarake, Drejtoria
20 e Policisë Ushtarake ju sqaron se kompania e policisë
21 ushtarake e zonës operative merr dhe zbaton urdhrat e
22 komandantit të zonës operative, ndërsa Drejtoria e Policisë
23 Ushtarake emëron komandantët e kompanive në zonat operative,
24 kontrollon si dhe mbikëqyr mbarëvajtjen e policisë ushtarake
25 të UÇK-së".

1 E patë këtë?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe pajtoheni me mua si
4 një person ushtarak i arsimuar, që ky është një shembull se si
5 funksionon hierarkia. Flasim hierarkia ushtarake, kështu?

6 PË. E para, këtë dokument asnjëherë nuk e kam parë. E dyta
7 nuk muj me komentu një dokument që as, që nuk e kam pasur
8 asnjëherë, edhe një dokument se nuk e di edhe nga ka ardh.
9 Edhe ajo çka thashë --

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshmitar, do t'ju ndaloj.
11 Do t'ju ndaloj. Nuk ishte kjo pyetje ime. Pyetje ime ishte
12 kjo: A pajtoheni me mua, mund dhe mos të pajtoheni nëse
13 dëshironi, sepse jeni person që keni përvojë ushtarake, a
14 s'është ky një shembull se si funksionon hierarkia ushtarake,
15 po ajo jo?

16 PË. Jo.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim pikën 2, ku thuhet:
18 "Në rastin e nevojës së arrestimit të personave duhet të
19 posedoni fletë-arrest nga komandanti i zonës operative".

20 Pajtoheni apo jo me parashtrimin tim që ky është Shtabi i
21 Përgjithshëm i UÇK-së që urdhëron policinë ushtarake të zonës
22 se si të kryejë arrestimet. Pajtoheni apo jo?

23 PË. Nuk pajtohena.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na thoni pse nuk
25 pajtoheni?

1 PË. Nuk pajtohenë për një dokument që nuk e kam parë
2 asnjherë edhe nuk e di nga ka ardhë. Edhe gjatë luftës --

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshmitar, nuk ishte kjo
4 pyetja ime. Ndaloni, ju lutem. Pyetja ime ishte kjo, dhe unë
5 po e përsëris. A pajtoheni apo jo me parashtrimin që po bëj
6 unë, që në këtë rast është Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që
7 urdhëron policinë ushtarake të zonës se si të kryejë
8 arrestimet? A pajtoheni apo nuk pajtoheni me këtë që thashë?

9 PË. Nuk pajtohenë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pse nuk pajtoheni?

11 PË. Nuk pajtohenë me këtë se asnjë rast të tillë në zonën e
12 përgjegjësisë ku kam qenë unë, nuk kemi pas. Edhe asnjë
13 dokument të tillë nuk e kam parë. Edhe nuk mund me u pajtu me
14 një gja që në praktikë nuk e kam parë asnjherë edhe nuk kam
15 posedu ato dokumenta.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po prapë s'ishte kjo
17 pyetja. Unë po them, a pajtoheni që në të vërtetë kjo është
18 një urdhëresë, është një urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm
19 drejtuar zonës për mënyrën se si duhet të kryenin arrestimin e
20 personave, a pajtoheni po nuk pajtoheni?

21 PË. Nuk pajtohenë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thotë, më tej:

23 "Për parregullsitë që vërehen, duhet të reagoni me shkrim
24 përmes komandës së zonës operative e cila është e obliguar t'i
25 bartë në DPU të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së."

1 A pajtoheni apo nuk pajtoheni me parashtrimin tim që ky
2 është një urdhër drejtuar nga Shtabi i Përgjithshëm për
3 policinë ushtarake të zonës se si të trajtonin këtë aspekt? Se
4 si të merreshin me këtë aspekt?

5 PË. Nuk pajtohena.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na thuaj pse nuk
7 pajtohesh.

8 PË. E thashë edhe për pikën 2. Me një dokument që asnjëherë
9 nuk e kam parë, me një dokument që nuk e kam praktiku në zonën
10 e përgjegjësisë time, nuk mund të pajtohena. Edhe nuk është
11 kompetencë e imja të flas për komandën e zonës apo për Shtabin
12 e Përgjithshëm.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka një P.S. në fund,
14 thuhet:

15 "Për sqarime të tjera Drejtoria e Policisë Ushtarake" --
16 e Shtabit të Përgjithshëm, nënkuptohet, "do t'ju vizitojë së
17 shpejti".

18 E shihni?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet të ketë
21 ndodhur kjo vizitë, Dëshmitar, apo nuk keni dijeni për diçka
22 të tillë?

23 PË. Asnjëherë në, nuk -- nuk kam njohuri që ka pas një vizitë
24 të tillë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por ju e dini ama që për

1 koordinimin mes zonës dhe Shtabit të Përgjithshëm pjesërisht
2 kjo është kryer nga Fatmir Limaj, këtë e dini besoj?

3 PË. Nuk e di.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim librin tuaj
5 atëherë. Është faqja 23 në anglisht. Dhe faqja 036643 e
6 anglishtes. 077075 [Sipas përkthimit] në shqip. Dhe ju këtu
7 thoni:

8 "Pas krijimit të njësiteve luftarake në komunën e
9 Kaçanikut dhe falë lidhjeve mes Shukri Bujës dhe Fatmir Limaj,
10 UÇK-ja kishte një rrjet lufte funksional. Ishte koha për një
11 hap tjetër tashmë. Pas mbërritjes së Imer Ilazit, Shukri Buja
12 dhe Fatmir Limaj menduan ta vendosnin atë si personin
13 përgjegjës për të organizuar komunën e Ferizaj."

14 Pastaj është një fragment tjetër në librin tuaj, në faqen
15 20, që është faqja 036640. Ju thoni:

16 "Gazetari", Shkuri Buja, "koordinonte po ashtu
17 aktivitetet mes Zefit", Agim Bajrami, "dhe Çelikut, dhe Çeliku
18 po nga ana e vet koordinonte me Shtabin e Përgjithshëm."

19 A ju kujtohet t'i keni thënë këto në librin tuaj, dhe
20 nëse i keni thënë, u qëndroni këtyre?

21 PË. E përsëris prapë. Këto kanë qenë supozime të mia, këto
22 kanë qenë zmadhime të mia, se nuk kam mundur unë me ditë në
23 fillim të marsit 1998 çka ka ndodhë mes këtyre personaliteteve
24 derisa unë në UÇK jam kyç më 1 qershor 1998.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra ju po thoni, dhe më

1 thoni nëse e kam kuptuar siç duhet, ju po thoni që nuk u
2 qëndroni këtë, nuk i qëndroni kësaj që sapo lexova nga libri
3 juaj?

4 PË. Nuk i qëndroj, për shkak se në atë kohë nuk kam qenë
5 pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri më 1 qershor.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim një dokument
7 tjetër. Është prova materiale P872. Me të njëjtin numër edhe
8 në gjuhën shqipe.

9 Lexojeni për një çast, na thoni kur të keni përfunduar.

10 PË. E kam lexu.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, këtu përpara, kemi
12 një dokument nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, Drejtoria e
13 Policisë Ushtarake sërish, lexon, ka një numër pra, 06/10, i 1
14 shkurtit të 1999, sekret ushtarak. I drejtohet komandës së
15 zonës operative të Nerodimës.

16 A mund ta lexoni ju titullin për ne, me zë ju lutem?

17 PË. Cilin titull?

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Titullin që është me
19 shkronja të mëdha në mes, "Obligon", ajo që fillon "Obligon".

20 A mund ta lexoni ju për ne këtë ju lutem?

21 PË. "Obligon zonën operative të Nerodimës".

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, a pajtoheni me mua që
23 ky është një urdhër që i është dërguar nga Drejtoria e
24 Policisë Ushtarake Shtabit të Përgjithshëm?

25 PË. Unë personalisht nuk pajtoheni me këtë urdhër, se

1 asnjëherë nuk e kam parë. Dhe edhe sikurse ta kisha parë këtë
2 urdhër, vetëm me nënshkrim nuk e kisha pranë. Kështu që për
3 mua është dokument i pavlefshëm.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po të paktën pajtohemi që
5 është një urdhër --

6 PË. Q'ashtu po shkrun, por për mu është i papranushëm edhe në
7 kohë lufte, edhe as sot, sot për herë të parë po e shoh.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj këtë. Urdhri te
9 pika 1 thotë:

10 "Zona operative e Nerodimës duhet ta propozojë një
11 kandidat për kuadër pranë Drejtorisë së Policisë Ushtarake të
12 UÇK-së".

13 E shihni?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas ka edhe kushtet, te
16 pika II dhe III, çfarë kushtesh duhet të përmbushë ky person.
17 Apo çfarë kualifikimi duhet të ketë, kështu? Po, kështu?

18 PË. Kështu po shkrun.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në fund të faqes,
20 edhe në shqip ju lutem. Ka vulën e UÇK-së, ka dhe një
21 nënshkrim. E shihni?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni ndonjë arsye për të
24 besuar që ky nuk është dokument origjinal apo dokument...?

25 PË. Dy arsye. E para asnjëherë nuk e kam parë këtë dokument.

1 E dyta, nuk ka emën e mbiemën. Veç me nënshkrim, për mu nuk
2 tregon shumë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Arsyeja pse nuk e keni
4 parë këtë dokument, ju na thatë, është sepse ju s'kishit
5 lidhje fare me policinë ushtarake.

6 PË. Sigurisht.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është kjo arsyeja që pse
8 s'e keni parë një dokument të tillë?

9 PË. Sigurisht. Edhe me polici, edhe, kam qenë zëvendës
10 komandant në brigadë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është koha
12 për pushimin e drekës, ju lutem shoqëroni dëshmitarin jashtë
13 sallës.

14 Dëshmitar, mos flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë
15 sallës së këtij gjyqi ju lutem.

16 DËSHMITARI: Në rregull.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
19 orën 14.30

20 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.03

21 --- Seanca rifillon në orën 14.30

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
23 vijojmë me dëshminë e dëshmitarit 4576 kam një urdhër
24 gojarisht për pranimin e deklaratave të mëparshme me
25 papërputhshmërinë të Dëshmitarit 4576.

1 Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja ka bërë të ditur me postë
2 elektronike pjesët e deklaratave të mëparshme të këtij
3 dëshmitari, të cilat ia ka lexuar dëshmitarit dhe të cilat
4 kërkojnë që të pranohen për në prova gjyqësore. Trupi Gjykses
5 verën që Mbrojtja e Thaçit ka bërë të ditur se i qëndron
6 kundërshtimit për pranimin e këtyre pjesëve.

7 Rregullorja 143(1) parashikon që:

8 "Pala e cila i bën pyetje dëshmitarit mund t'i bëjë, pra,
9 pala thirrëse mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit dhe mund t'i
10 tregojë dëshmitarit çfarëdo dokumenti apo dëshmie tjetër në
11 përputhje me këtë rregulloren. Nëse dëshmitari nuk mund të
12 rikujtojë faktet që ai ka dhënë në një deklaratë të mëparshme
13 dhe nëse, në këtë rast, më falni, dëshmitari me leje të Trupit
14 Gjykses mund t'i tregohen dokumente për t'ia rifreskuar
15 kujtesën".

16 Kjo dispozitë kërkon që autorizimi i Trupit Gjykses të
17 kërkohet për të rifreskuar kujtesën e dëshmitarit.

18 Kjo është bërë dhe leja është dhënë në raste përkatëse
19 për këtë qëllim. Trupi Gjykses, në veçanti, tërheq vëmendjen
20 te projekt-transkripti i ditës së djeshme në faqet 12668 deri
21 në 12669.

22 Pastaj rregulla 143(2)(c) parashikon që me lejen e Trupit
23 Gjykses pala thirrëse mund t'i bëjë pyetje këtij dëshmitari
24 lidhur me pika e mëposhtme të lidhura me besueshmërinë e
25 dëshmitarit. Më konkretisht në pikën (c) "nëse dëshmitari në

1 një moment të caktuar ka bërë deklaratë me papërputhshmëri më
2 përpara”.

3 Në veçanti e kam fjalën për faqet 12672 deri 12673 dhe
4 12701 të projekt-transkriptit të ditës së djeshme.

5 Rregulla 143 nuk kërkon që të merret leja sa herë që
6 bëhet një pyetje e tillë. Kërkon vetëm që të kërkohet leja për
7 të konstatuar nëse dëshmitari ka pasur deklaratë me
8 papërputhshmëri përpara.

9 Kjo përputhet edhe me qasjen e ndjekur nga dhoma e apelit
10 në çështjen Popovic të TPNJ-së ku është kërkuar, ku kërkohet
11 që vetëm procesi i diskreditimit plotësisht të një dëshmitari
12 të autorizohet nga Trupi Gjykses. Nuk është sugjeruar që sa
13 herë që bëhet një pyetje që vënë, që bën pala thirrëse
14 dëshmitarit lidhur me papërputhshmërinë në versionet e
15 mëparshme duhet që të kërkojë një kërkesë të re sipas
16 rregullës 143(c) [Sipas përkthimit].

17 Gjithashtu natyra me papërputhshmërinë e një deklaratë të
18 mëparshme mund të dalë në pah vetëm gjatë dhënies së dëshmisë
19 në sallë të dëshmitarit, me ç’rast kërkohet edhe rifreskimi i
20 kujtesës apo kur dëshmitari nuk pranon atë që ka thënë
21 përpara.

22 Procedura përkatëse është ndjekur në këtë rast. Trupi
23 Gjykses e ka bërë të qartë që pala thirrëse është e lejuar që
24 ta përdorë deklaratën e mëparshme.

25 Sugjerimi që Trupi Gjykses ka shkelur nenin 6 të

1 Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk është me
2 bazë. Së pari, në mënyrë të përsëritur është ngritur çështja e
3 themelit nga pala Mbrojtëse. Trupi Gjykues vëren, ka vërejtur,
4 më falni, në një dosje paraprake ku përmbaheshin më shumë se
5 20 referenca të intervistës që ka dhënë dëshmitari 4576 me
6 ZPS-në. Mbrojtja është njoftuar, pra, lidhur me dokumentet që
7 ku ka synuar të mbështetet ZPS-ja. Dhe ky njoftim konsiderohet
8 se është i përforcuar nga kërkesa e ZPS-së për të paraqitur
9 këtë deklaratë përmes rregullës 154.

10 Sugjerimi që mungon njoftimi nuk është me bazë.

11 Së dyti, e drejta e Mbrojtjes për një proces kontradiktor
12 është plotësisht ruajtur nga mundësia për të bërë pyetje
13 dëshmitarit sipas dëshirës së vet lidhur me deklaratën e
14 mëparshme apo pjesë të tjera të intervistës.

15 Së treti, Mbrojtja nuk ka arritur që të vërtetojë cenim,
16 por do të ketë mundësi që t'i bëjë pyetje dëshmitarit për të
17 gjitha aspektet përkatëse dhe për të cilat avokati i z. Thaçi
18 ka bërë të ditur se ato janë të përgatitur që t'i bëjnë
19 pyetje, për të cilat mund t'i bëjnë pyetje dëshmitarit.

20 Në bazë të asaj që është thënë, Trupi Gjykues bindet se
21 pjesët e ofruara nga intervista e këtij dëshmitari me ZPS-në i
22 përputh kriteret për pranim sipas rregullës 143(2)(c) dhe
23 138(1). Ato pjesë të intervistës së ZPS-së me dëshmitarin 4576
24 kanë përpunshmëri me dëshminë që ka dhënë këtu në gjykatë,
25 kanë lidhje me çështjen, kanë vlerë provuese në pamje të parë,

1 janë autentike në pamje të parë dhe kjo vlerë në pamje të parë
2 provuese nuk cenon Mbrojtjen.

3 Trupi Gjykses pranon pjesët e mëposhtme të deklaratave të
4 Dëshmitarit 4576 siç janë ofruar nga ZPS-ja për t'u pranuar në
5 provat gjyqësore. Janë pjesët: një, 074301-TR-ET Pjesa 1 RED,
6 faqe 24, rreshtat 16 deri 20; dy, 07431-TR-ET [Sipas
7 përkthimit] Pjesa 1 RED, faqe 27 [Sipas përkthimit], rreshti
8 22 deri 26, rreshti 8; katër [Sipas përkthimit] 074301-TR-ET
9 Pjesa 2 RED, Pjesa 18 [Sipas përkthimit], rreshti 22 deri në
10 19, rreshti 20; pesë, 074301-TR-ET Pjesa 4 RED, faqja 6,
11 rreshti 13 deri në faqen 7, rreshti 5; dhe, në fund P074301-
12 TR-ET Pjesa 1 RED, faqja 17, rreshti 13-12 [Sipas përkthimit].

13 Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

14 Z. PACE: [Përkthim] Dua të verifikoj, mbase e kam dëgjuar
15 gabim. Në referencën e parë neve kemi kërkuar të pranohet
16 faqja 24, rreshtat 16 deri 22, por unë dëgjova 16 deri në 20.
17 Desha të sigurohem që është e saktë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po është
19 numri një, e para, pra. Besoj Pjesa 1 [Sipas përkthimit],
20 faqja 24, rreshti 16 deri në 22.

21 Z. PACE: [Përkthim] Po, kjo është e saktë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
23 atëherë.

24 Mund të fusni dëshmitarin në sallë.

25 Ah, po mund t'i caktoni numrat [e pakuptueshme] përpara.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 deklarata e dëshmitarit me numër ERN 074301-TR-ET Pjesa 1 RED
3 dhe përkthimi përkatës shqip përfshin dhe pjesët të
4 sapopranuara në provat gjyqësore do të marrin numrin e provës
5 materiale P01020.1.

6 Pjesa 2 e kësaj deklarate 074301-TR-ET Pjesa 2 RED dhe
7 përkon me përkthimin në shqip, pjesët që sapo janë pranuar, do
8 të marrin numrin e provës materiale P01020.2.

9 Dhe deklarata me numër ERN 074301-TR-ET Pjesa 4 RED dhe
10 përkthimi përkatës në shqip do të pranohen pjesët që sapo janë
11 lexuar dhe pranuar në procesverbal do të marrin numrin e
12 provës materiale P01020.3.

13 Me klasifikimin konfidencial.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Janë dhe tre
15 të tjera, znj. Sekretare.

16 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja e Seancës
17 këshillohen]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
19 çaktivizuar]

20 Z. PACE: [Përkthim] Ndërkohë që presim, kërkoj ndjesë, më
21 duket se Sekretarja tha që janë konfidenciale, por mendoj që
22 nuk ka arsye që të mos jenë publike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto
24 dokumente të fundit do të riklasifikohen të gjitha si publike.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
2 rikujtoj që jeni ende nën detyrim për të thënë të vërtetën siç
3 keni thënë në betim solemn. Do të vazhdojmë me pyetjet që do
4 t'i bëjë Gjykatësi Mettraux.

5 Pyetje nga Trupi Gjykses:

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
7 Smith.

8 Mirëdita, Dëshmitar. Kur u ndamë më përpara po ju pyesja
9 për policinë ushtarake në nivel zone. A mund të konfirmoni
10 fillimisht atë që keni thënë në libër, pra, që komandanti i
11 policisë ushtarake, i batalionit të policisë ushtarake ishte
12 Isak Musliu?

13 PË. Nuk, nuk mund ta konfirmoj këtë për shkak se nuk ka qenë
14 kompetencë e imja.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po e dini apo nuk e dini?
16 Keni dijeni apo jo që Isak Musliu ka qenë shefi i policisë
17 ushtarake, i batalionit, pra, i policisë ushtarake asokohe?

18 PË. Nuk e di dhe e bazoj në atë se asnjëherë nuk e kam
19 takuar.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ta shohim edhe një
21 herë librin tuaj 036622. Shkojmë te faqja 62, faqja 62 e
22 librit. Jo, më falni është 52, 0367, më falni, 036672 dhe në
23 versionin në shqip besoj se është 077089, faqja 59 [Sipas
24 përkthimit] e PDF-së. Po të ecni një faqe më përpara në shqip,
25 në anglishte ishte në faqen e saktë. Edhe një tjetër më tutje

1 në shqip, ju lutem. Faleminderit. Mund të shohim pjesën e
2 poshtme të të dyja faqeve, ju lutem.

3 Ajo që ne kemi këtu, pra, është një pjesë nga libri juaj.
4 Është një prej këtyre diagrameve që janë përfshirë në libër.
5 Ka të bëjë me komandën e zonës së Nerodimës në janar-shkurt,
6 qershor '99. Pajtohemi me mu për këtë?

7 PË. Po. Vetëm librin e kam bërë pas luftës edhe atë, 12 vite
8 pas lufte dhe në kohën e luftës nuk e kam dit dhe nuk e kam
9 njoft dhe nuk e kam takuar asnjëherë Isak Musliun.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, a mund të na thoni se
11 kë keni vendosur si shef të batalionit të policisë ushtarake
12 në diagramin tuaj? Është në pjesën e poshtme djathtas.

13 PË. Ajo që shihet në bazë të librit që e kam shkru pas lufte
14 është Isak Musliu.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dy faqe më përpara në
16 libër ju thoni dhe po citoj:

17 "Komandanti i Policisë Ushtarake të Zonës Operative të
18 Nerodimës u bë Isak Musliu-Qerqiz".

19 A njihni ndonjë tjetër, a dini nëse ndonjë tjetër veç
20 Isak Musliut ka qenë komandant i policisë ushtarake në nivel
21 zone në '98 dhe në '99?

22 PË. Nuk kam njohuri që të ketë qenë dikush tjetër, por edhe
23 për Isak Musliun e thashë më herët që as nuk e kam dit as nuk
24 e kam taku asnjëherë gjatë luftës.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, e keni thënë, pra, e

1 keni futur në libër jo një herë, por dy herë, po pa pasur
2 asnjë bazë, kështu?

3 PË. E kam thënë që në librin shumicën e rasteve i kam paraqit
4 ashtu qysh kam pas dëshirë e jo qysh ka qenë në realitet.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju pyes për dy
6 individë të tjerë: Një është Enver Axhami; e dini kush është
7 ky person?

8 PË. Ka qenë një ushtar në Brigadën 162 "Agim Bajrami".

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të na thoni se çfarë
10 funksioni kishte gjatë lufte? Dhe nëse janë disa funksione që
11 i ka kry na i thonë këto.

12 PË. Vetëm një detyrë ka qenë. Ushtar i thjeshtë dhe në
13 shoqërim të komandantit të brigadës, Qamil Ilazit.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, me fjalë të tjera
15 ishte shoqërues i komandantit të brigadës, kështu?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jeni në dijeni se përpara
18 se të bëhej shoqërues i Qamil Ilazit kishte qenë anëtar i
19 njësitit të Fadil Cakës, e dini këtë?

20 PË. Nuk e kam pat këtë informatë asnjëherë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Personi i fundit për të
22 cilin dua t'ju bëj pyetje është, ju janë bërë pyetje për këtë
23 më përpara, është Ejup Runjeva dhe keni konfirmuar besoj se ka
24 qenë anëtar i Brigadës 162?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka qenë anëtar i
2 strukturës së komandës së brigadës, është e vërtetë?

3 PË. E vërtetë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se i keni thënë ZPS-
5 së gjatë intervistës suaj se nuk dinit asgjë për krimet për të
6 cilat Ejup Runjeva, Rustem Dema dhe Enver Axhami janë
7 shpallur fajtorë. Kjo është, ky është versioni juaj apo jo?

8 PË. E saktë. Nuk kam pas asnjë informatë. Jo që s'kam pas
9 informatë por asnjëherë nuk kanë bë krime këta persona që po i
10 përmendni.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por e dini, keni dijeni se
12 janë proceduar penalisht në Kosovë dhe janë shpallur fajtorë
13 për keqtrajtim të të ndaluarve, personave të ndaluar. Këtë e
14 dini apo jo?

15 PË. E kam kuptuar më vonë, por nuk jam marrë me atë punë se
16 thjesht e kam thënë edhe dje se nuk asnjëherë nuk iu kam besu
17 atyne proceseve të montuara të UNMIK-ut që janë bazu në
18 propagandën serbe.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por në dallim nga ajo që
20 ju sapo thatë më përpara ata kanë kryer krime kundër personave
21 të ndaluar. E pranoni këtë?

22 PË. Nuk e pranoj asnjëherë nuk kanë kry krime. Dhe nuk kam
23 njohuri.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Le të imagjinojmë për një
25 çast sikur të kenë kryer krime. Përgjegjësia e kujt do të

1 kishte qenë brenda brigadës që të ndërmernte hapa kundër
2 personave brenda brigadës së tyre nëse do të merrnin dijeni
3 për veprimet e tyre? Kush ishte përgjegjës për marrjen e
4 këtyre masave?

5 PË. Deri sa nuk ka pas, nuk ka bë askush krime të luftës, nuk
6 muj me i imagjinu se çka do të kishte ndodhur me ata. Nuk ka
7 pas raste që ushtarët e Brigadës 162 kanë bë krime. Po janë
8 forcat e okupatorit serb që kanë bë krime ndaj qytetarëve në
9 Kaçanik në veçanti ku ka qenë zona e përgjegjësisë sime, por
10 në përgjithësi edhe në krejt Kosovën.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani të sigurojmë që po e
12 kuptojmë dëshminë tuaj. Nëse ju zëvendëskomandanti i brigadës,
13 pastaj komandant i brigadës, në qoftë se do të merrje dijeni
14 që këta do të mësoje, pra, që këta tre individë kishin
15 keqtrajtuar shumë keq persona të ndaluar, civil të ndaluar,
16 nuk do të kishit bërë asgjë? Apo e kam kuptuar gabim nga
17 përgjigja juaj?

18 PË. Nuk jemi kuptuar. E përsëris prapë, këta persona nuk kanë
19 bë asnjë krim lufte ndaj asnjë personi civil.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë e keni thënë, këtë e
21 thatë tri herë --

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- po ajo pyetje që po bëj
24 është kjo, edhe pra, pyetje.

25 PË. E thamë si zëvendëskomandant në përgjegjësinë time nuk

1 kisha leju që të ndodhë ndonjë krim.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nëse e kuptoj saktë
3 prej jush, ju e pranoni apo jo që si ju si zëvendëskomandant
4 edhe si komandant i brigadës do ta kishit pasur kompetencën
5 disiplinore për të marrë masa dhe për të ndërmarre hapa kundër
6 individëve të tillë?

7 PË. Në asnjë formë nuk kisha leju që të ndodhë ndonjë krim.
8 Edhe nuk ka ndodh.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë po e marr si po
10 këtë përgjigje.

11 Kalojmë tani te prova materiale me numër P899. Jo, më
12 mirë P897. Shkojmë drejt e te P897.

13 Ju kujtohet që ju kanë bërë pyetje për faktin që anëtarë
14 të UÇK-së ishin të lirë që mund të largoheshin dhe të
15 ktheheshin si të dëshironin në radhët e UÇK-së. Se ju sikur
16 thatë që nuk ekzistonte termi dezertor në UÇK. Ju kujtohet që
17 u bë ky lloj diskutimi në një moment?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju tregoj diçka që e
20 kemi. Nuk vjen nga brigada juaj, nga një brigadë fqinje,
21 Brigada 161 që titullohet "Vendim mbi ndalimin disiplinor...",
22 i datës 3 maj '99, nënshkruar nga komandanti i Brigadës 161. E
23 shihni përpara në ekran?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Siç e shihni këtu ky

1 vendim mbështetet në nenin 17(1), 18(2), 20(f) të Rregullores
2 Disiplinore të UÇK-së. E shihni këtë këtu?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e parë është
5 kjo: Asokohe ishit në dijeni që ekzistonte një rregullore
6 disiplinore e UÇK-së? Kishit dijeni për këtë?

7 PË. Nuk kam pas dijeni.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pastaj këtu shpjegohet dhe
9 ju kërkoj që edhe ta lexoni vetë, ta shihni vetë. Ushtari në
10 fjalë ka datëlindjen aty, i shqiptohet 15 ditë ndalim si masë
11 ndalimi disiplinor duke filluar nga 3 maji '99, deri më 18 maj
12 '99. Ka të drejtën që ta apelojë. Pra, mund të bëjë ankesë dhe
13 tek arsyetimi thotë që:

14 "Ky vendim i shqiptohet ushtarit si masë disiplinore për
15 shkak se ka cenuar prestigjin e ushtarit duke lëshu pozicionet
16 pa urdhrin e eprorit".

17 "Ndalimi disiplinor do të arrijë efektin që të mos
18 përsëriten cenime të tilla".

19 E pranoni, zotëri, se ajo që shohim këtu të paktën për në
20 rastin e Brigadës 161, masa disiplinore janë marrë kundër
21 anëtarëve të UÇK-së se e kanë lëshu pozicionin dhe detyrën pa
22 leje. E pranoni këtë?

23 PË. Nuk mundem ta pranoj për një brigadë krejt tjetër edhe
24 për një dokument që e kam përpara vetit pa kurrfarë emri,
25 mbiemri. Vetëm shkruan komandanti i brigadës. Nuk ka kurrfarë

1 emri. Kështu që për mua nuk thotë asgjë ky vendim. Edhe është
2 i papranueshëm për mu.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani ta supozojmë se është
4 kështu siç është kjo. Po na thoni që Brigada 161 vepron
5 ndryshe nga Brigada 162 për këtë çështje? Pra, në rastin e
6 Brigadës 161 ushtari po ta lëshonte pozicionin disiplinor nëse
7 në rastin e Brigadës 162, jo, këtë po dëshmoni?

8 PË. Unë muj vetëm për Brigadën 162 me dëshmu se asnjë ushtar
9 nuk i ka lëshu detyrat, radhët e Brigadës 162 "Agim Bajrami".
10 Dhe të gjithë ata që i kanë marrë detyrat dhe i kanë kry. Për
11 brigadat e tjera nuk është kompetencë e imja të komentoj apo
12 të supozoj se çdo gjë që të them muj mos me qenë real.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'ju pyes edhe një herë,
14 mbase një pyetje spekuluese. Po të kishte pas ndodh kjo në
15 brigadën tuaj. Pra, siç kjo që ka ndodh që tregohet te ky
16 dokument, ta kishte lëshu, të ishte largu, pra, nga pozicioni
17 i vet ushtari, ju s'do të kishit marrë asnjë masë disiplinore,
18 këtë po thoni?

19 PË. Nuk, nuk ka pas raste të tilla në brigadën time se në
20 gjatë komunikimit me ushtarët e mi gjithherë kam bashkëbisedu
21 edhe kam thënë se ata që lodhen, ata që kanë nevojë me vizitu
22 familjet lirisht le t'i drejtohen brigadës. Për atë dhe nuk
23 kemi pas asnjë rast që të jemi ballafaqu me kësi vendime.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk -- më duket se nuk iu
25 përgjigjët pyetjes. Ta zëmë se ekziston rasti kur nuk ka

1 kërkuar leje personi. Nëse një prej ushtarëve tuaj, të
2 brigadës tuaj të ishte largu nga pozicioni nga pozita pa lejen
3 tuaj, ju po thoni që nuk do të kishte pas asnjë pasojë për
4 atë? S'do ishte marrë asnjë masë kundër tij apo kundër saj?
5 PË. Po derisa nuk kam pas asnjë rast, nuk muj me spekul, as
6 nuk muj me supozu se po e shoh edhe që tash që për ato gjëra
7 që kam supozu po duhet me dhënë përgjegjësi. Kështu që nuk
8 muj me supozu për rastin se në brigadën time nuk ka pas ksi
9 raste.

10 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
13 çaktivizuar]

14 Gjykatësi Barthe nuk ka pyetje.

15 Ka ndonjë pyetje të mëtutjeshme nga Prokuroria që burojnë
16 nga pyetjet e Gjykatësve?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kam unë pyetje. Faleminderit.

20 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, mirëdita edhe një herë.

23 PË. Mirëdita.

24 PY. Kam disa pyetje shtesë që burojnë nga pyetjet e

25 Gjykatësit Mettraux. Pikë së pari, do doja t'ju bëja një

1 pyetje lidhur me disa pyetje që bëri Gjykatësi Mettraux dhe
2 janë të pasqyruara këto në transkript në faqen 81 në fillim të
3 rreshtit 20. Pyetjet kishin lidhje me faktin kujt i raportonte
4 komandanti i zonës dhe Gjykatësi Mettraux ju tregoi
5 intervistën që i kishit dhënë ZPS-së; jua vendosi përpara në
6 ekran, por unë do lutesha ta vendosnim sërish këtë intervistë
7 në ekran, sepse do doja të lexoja më shumë nga ato që ju ka
8 lexuar Gjykatësi Mettraux.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, të shkojmë në Pjesën 2, faqja
10 14. Edhe një herë, bëhet fjalë për materialin 074301-TR-ET
11 Pjesa 2.

12 PY. Pyetja ishte kjo: Kujt i raportonte Shukri Buja? Po e jap
13 si për kontekst këtë që ta kuptoni për çfarë do të diskutojmë,
14 që ta kuptoni për çfarë do diskutojmë. Shihni në ekran dhe
15 ndiqeni në shqip dhe besojmë që në fakt te transkripti në
16 anglisht ka një problem përkthimi. Gjykatësi Mettraux fillon
17 te rreshti 14:

18 "Kujt i raportonte komandanti i zonës?"

19 Dhe ju u përgjigjët kështu ZPS-së:

20 "Nuk kam qenë komandant zone, në fakt, por normalisht i
21 raportonin Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Por komandanti i
22 zonës, nëse do të kishit, do të kishte raste ta takonte. Ai
23 mund t'ju tregojë më shumë për këtë, në qoftë se do ta
24 takoni".

25 Pyetja e radhës:

1 "Po me sa kuptoni ju struktura ishte kështu: Ekzistonte
2 Shtabi i Përgjithshëm dhe nën Shtabin e Përgjithshëm ishin
3 zonat dhe më pas në varësi të zonave ishin brigadat, kështu
4 po, po thoni?".

5 Jeni përgjigjur:

6 "Po".

7 PË. Thjesht ka qenë një supozim i imi se nuk ka qenë
8 kompetencë e imja.

9 PY. Më lejoni ta përfundoj leximin e intervistës dhe pastaj
10 do jua bëj pyetjen. Vijon me pyetjen e radhës:

11 "Në cilësinë tuaj, duke filluar nga pozita jua si
12 zëvendëskomandanti, a kishit ju kompetenca për të lëshuar
13 urdhra për ndokënd?".

14 Ju përgjigjeni sërish:

15 "Dua t'jua shpjegoj edhe një herë këtë. Dua t'jua bëj të
16 qartë, kur them komandant, komandanti i brigadës i raportonte
17 komandantit të zonës, unë nuk e dija, por supozoj se kështu
18 funksiononte në varësi të strukturës, sepse unë nuk kam qenë
19 vetë personalisht, asnjëherë nuk kam qenë personalisht tek
20 Shtabi i Përgjithshëm".

21 Dhe dua që këtë fjali të na sqaroni këtu. Në shqip fjalia
22 e radhës sot thotë që:

23 "Nuk mund t'ju garantoj që komandanti i zonës raportonte
24 gjëkund, por supozoj që komandanti i zonës i raportonte
25 strukturës eprore".

1 A thuhet kështu në shqip? Shikojeni dhe shqipen, në
2 rreshtin 4 në shqip, ju lutem. Shiheni. A thuhet siç u tha nga
3 përkthyesi me gojë?

4 PË. Thjesht e kam shkru këtë se ka qenë një supozim i imi për
5 shkak se nuk ka qenë kompetencë e imja. Edhe po shkruan këtua:
6 Po, unë po shkoj prej supozimit se mund të ketë qenë kështu,
7 por megjithatë nuk ka qenë kompetencë e imja dhe nuk kam pas
8 njohuri unë për këtë.

9 PY. Ju lutem, na e lexoni ju çfarë thuhet në shqip në
10 rreshtin 4. Lexoni me zë në shqip rreshtin 4 tek shqipja që
11 keni përpara.

12 PË. Rreshti 4 -- te 3-shi:

13 "Personalisht nuk kam qenë asnjëherë në Shtabin e
14 Përgjithshëm. Domethënë, për çat sa se nuk mundet nuk muj
15 tashti me garantu se komandanti i zonës i ka raportu" se është
16 pika, pika, nuk po e di çka ka desht më thënë. "Por unë po
17 shkoj prej supozimit se i ka raportu një organi më të lartë".

18 Ky vetëm ka qenë një supozim i imi masi unë nuk kam marrë
19 pjesë në atë dhe nuk kam qenë komandant i zonës.

20 PY. Po, këtë donim të sqaronim që në fakt ju i keni thënë
21 ZPS-së që ju thjesht po supozonit, kështu? Thjesht po
22 supozonit?

23 PË. Ashtu është edhe në këtë transkript.

24 PY. Po, në rregull. Ju kanë bërë pyetje më pas kujt i
25 raportonte Xhabir Elezi. Tani unë kam këtë pyetje: Xhabir

1 Elezi kujt i raporte pas 15 majit 1999?

2 PË. Pas 15 majit përgjegjësinë kryesore në Brigadën 162 e kam
3 pasur unë. Por nuk kemi ndonjë rast të raportimit klasik apo
4 një raportimi se nuk kemi pas ndonjë aktivitet që është dashtë
5 me raportu qoftë me gojë qoftë me shkrim. Por përgjegjësinë
6 kryesore në Brigadën 162 nga 15 maji deri me 11 qershor e kam
7 pas unë.

8 PY. Xhabir Elezi të ka raportuar ndonjëherë ty që prej 15
9 majit deri 11 qershor?

10 PË. Nuk kemi pas rast përveçse se janë zhvillu luftime të
11 ashpra dhe shpejt edhe ka përfunduar, ka përfunduar lufta.

12 PY. Flasim për një temë tjetër. Bëhet për fjalën si të
13 interpretojmë disa nga dokumentet që ju paraqiti Gjykatësi
14 Mettraux, dokumentet që ishin kërkesa për këshilla dhe ai
15 ishte a s'ishte urdhër një dokument i caktuar.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti i parë që dua të shfaqet
17 në ekran është një dokument që pretendohet se është një
18 urdhër. Për këtë do lutesha që të vendosim në ekran provën
19 materiale P01017.

20 PY. Fjala me çfarë thuhet me shkronja të mëdha dhe të errëta,
21 çfarë lexon kjo fjalë?

22 PË. Në fillim?

23 PY. Në mes, në mes të faqes, në mes të faqes me shkronja, të
24 gjitha germet e mëdha edhe të theksuara.

25 PË. "Urdhëresë".

1 PY. "Urdhëresë". Është një urdhëresë e lëshuar nga Bislim
2 Zyrapit. Ju mendoni se Shtabi i Përgjithshëm nëse keni dyshim
3 që Shtabi i Përgjithshëm nuk do të dinte si ta përdorte fjalën
4 "urdhëresë" nëse kishin nevojë të nxirrnin një urdhër të
5 tillë?

6 PË. Edhe një herë pyetjen, ju lutem?

7 PY. Po. Jua kanë treguar këtë dokument nga ana e Prokurorisë
8 kur ju bënë pyetjet dhe unë po përpiqem, po flasim për
9 terminologjinë më shumë këtu. Ju mendoni që Bislim Zyrapit dhe
10 Shtabi i Përgjithshëm do të përdornin fjalën "urdhëresë" kur
11 kishin për synim që të urdhëronin dikën që të bënte diçka, do
12 e përdornin ata fjalën "urdhëresë", nëse synonin që të jepnin
13 një urdhër dikujt?

14 PË. Nuk kam njohuri për këtë se thjesht nuk muj me supozu çka
15 do të kishte bë Shtabi i Përgjithshëm.

16 PY. Shohim dokumentet që ju tregoi Gjykatësi Mettraux.
17 Fillojmë me provën materiale P887.

18 Ju keni qenë disa vite në ushtrinë jugosllave, kështu?
19 Keni shërbyer disa vite.

20 PË. Po.

21 PY. Po në TMK sa vite keni shërbyer?

22 PË. Dhjetë vite.

23 PY. Pra, për afërsisht keni 14-15 [Sipas përkthimit] vjet
24 përvojë ushtarake, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Shohim dokumentin në ekran. Shikoni lart majtas. Thuhet
2 këtu: "Sqarime dhe këshilla për kryerjen e detyrave".

3 Në 14 vjet që keni qenë në ushtri ju, sa herë ka ndodhur
4 që një vartës t'i shkruajë një eprori dhe t'i kërkojë
5 këshilla? Në përvojën tuaj sa herë ka ndodhur kjo që vartësi
6 t'i kërkojë këshilla një eprori?

7 PË. Asnjëherë.

8 PY. Sa herë i është përgjigjur komanda juaj diçkaje të tillë
9 për këtë sqarimin dhe këshillave? Sa herë u është përgjigjur
10 dokumenteve të këtilla? Ose më saktë a ka ndodhur kjo në 14
11 vjet përvojë që keni ju?

12 PË. Asnjëherë.

13 PY. Nëse dikush është vërtet epror, si mendoni ju se do i
14 drejtoheshin një vartësi? Çfarë dokumenti do përdorim kundrejt
15 një vartësi?

16 Z. PACE: [Përkthim] E kundërshtoj. Pyetja është shumë e
17 vagullt edhe nuk e shoh dot lidhjen me pyetjet e Gjykatësit
18 Mettraux. Dëshmitari nuk është ekspert.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se e
20 ka përgjigjen le ta japë.

21 DËSHMITARI: Edhe një herë pyetjen, ju lutem?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Do ta riformuloj madje
23 pyetjen. Një epror lëshon urdhra për një vartës, kështu? Është
24 kjo përvoja juaj?

25 PË. Po.

1 PY. Dikush që mund të jetë në nivel të barabartë mund të
2 lëshojë sqarim ose të kërkojë këshilla në nivele të barabarta,
3 pajtoheni me këtë?

4 PË. E saktë.

5 PY. Në rregull. Tani shohim këtë dokument këtu. Ju mendoni që
6 ky dokument që është dërguar mes dy palëve që janë të
7 barabarta, pra, që i është dërguar një personi që është në
8 nivel të barabartë dhe është kërkuar sqarim?

9 PË. Thjesht për mua ky dokument është i papranueshëm, i
10 pakuptueshëm, nuk e ka asnjë bazë të them as ligjore.

11 PY. Gjykatësi Mettraux ju pyeti, a është ky shembull se si
12 funksionin hierarkia ushtarake. Dhe unë po ju jap të
13 kundërtën, kundërparashtrim. Kjo është pikërisht një shembull
14 se si nuk duhet të funksionojë një hierarki ushtarake. A
15 pajtoheni me mua?

16 PË. E saktë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim provën materiale P872.

18 PY. U tregua, Gjykatësi Mettraux ju tregoi këtë dokument. Kjo
19 është më shumë se dy muaj pas urdhëresës së Bislime Zyrapit që
20 ju tregova pak më përpara. Në vend të fjalës "urdhëresë", këtu
21 përdoret fjala "obligon". Çfarë është "obligon" në terma
22 ushtarakë sipas jush? Si e kuptoni ju?

23 PË. Kjo nuk ka të bëjë me termat ushtarake.

24 PY. Në rregull. Atëherë për çfarë arsye e pranuat ju
25 sugjerimin e Gjykatësit Mettraux që kjo është një urdhëresë?

1 Pse e pranuat pyetjen sugjestionuese që kjo është një
2 urdhëresë?

3 PË. Absolut nuk e kam pranuar që është kjo një urdhëresë. Për
4 mua, e kam thënë që kjo nuk është një dokument valid. Edhe nuk
5 për mua as nuk e kam parë gjatë luftës as sot nuk është një
6 dokument që vlen.

7 PË. Në rregull. Nëse e kuptojmë siç duhet këtë dokument. Këtu
8 është Drejtoria e Policisë Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm
9 i kërkon zonës operative të Nerodimës të propozojë një
10 kandidat për kuadër pranë DPU-së së UÇK-së, ë a është kështu?
11 E kam kuptuar siç duhet?

12 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Dëshmitari nuk mund t'i
13 japë mendime dhe propozime një avokati si ta kuptojë një
14 dokument.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

16 Z. MISETIC: [Përkthim]

17 PY. Atëherë, Dëshmitar, do jem thjesht hipotetik këtu. Si e
18 kuptoni ju këtë "obligon", si e kuptoni këtë "obligim" apo
19 këtë "obligon" që Drejtoria e Policisë Ushtarake e Shtabit të
20 Përgjithshëm i kërkojë zonës operative të Nerodimës të
21 propozojë një kandidat për kuadër pranë DPU-së së UÇK-së? Pra,
22 Drejtoria e Policisë Ushtarake i kërkon zonës operative të
23 Nerodimës të emërojë dikë në policinë, pranë Drejtorisë së
24 Policisë Ushtarake, kështu e kuptoni ju këtë?

25 PË. Unë e kam thënë edhe më herët edhe prapë e përsëris. As

1 nuk po muj me kuptu këtë dokument dhe në kohën e luftës nuk e
2 kam parë edhe nuk ka të bëjë kjo absolut me dokumentat që e
3 thashë. Edhe fjala "obligon" nuk ka të bëjë me terminologjinë
4 ushtarake. Po edhe thirret se Drejtoria nuk ka as emër as
5 mbiemër vetëm nënshkrim. Për mua është një dokument më shumë
6 manipulues sesa një dokument real qysh duhet me qenë.

7 PY. Dëshmitar, e dimë që nuk keni ju dijeni për këtë
8 dokument. Unë po ju pyes jeni shqipfolës dhe jeni një person
9 që keni shërbyer në UÇK dhe në TMK. Unë po ju them lexojeni
10 dokumentin dhe më thoni çfarë mendoni ju se kërkohet, pra,
11 sipas jush çfarë kërkohet në këtë dokument?

12 PË. Ashtu qysh po shkruan se e kanë obligu zonën operative të
13 Nerodimës edhe në thonjëza, nuk po e di për çka e kanë, për
14 çka e kanë shti. Ta propozojë një kandidat për kuadër pranë
15 Drejtorisë së Policisë Ushtarake. Kështu po shkruan, po për
16 mua nuk, është dokument i panjohur edhe jo i dokument qysh
17 duhet me qenë.

18 PY. Në rregull. Pra, nga përvoja juaj, a është normale kjo, a
19 është procedurë normale ushtarake kjo që komanda eprorë t'i
20 kërkohet komandës vartëse që të propozojë dikën që të jetë
21 pjesë e komandës më të lartë eprorë, a është kjo një procedurë
22 normale?

23 PË. Sipas meje nuk është.

24 PY. Në rregull. A mendoni ju se ky është një shembull e një
25 hierarkie ushtarake jofunksionale?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 120

1 PË. E saktë.

2 PY. Dhe në fund ju bëri disa pyetje Gjykatësi Mettraux për
3 autoritetin, për masat disiplinore. Dhe në disa përgjigje
4 tuaja thatë që nuk do ta kishit lejuar, ju nuk do ta kishit
5 lejuar keqtrajtimin e civilëve.

6 Pyetja ime është kjo: Çfarë kompetenca kishit ju, në
7 dashtë si zëvendëskomandant apo si komandant të disiplinonit
8 ushtarët? E dimë që nuk ka ndodhur, por çfarë, në atë kohë ju
9 çfarë mundësish kishit më saktë për të disiplinuar ushtarët?

10 PË. Nga detyra ime si zëvendëskomandant për operacione
11 luftarake që i kanë pranë ushtarët e rinj, që i kanë
12 përgatitur me detyra të ushtarëve, që i kanë përgatitur
13 përdorimin e armatimit, që i kanë përgatitur për vijën e
14 frontit gjithherë edhe këtë ia kam komunikuar që ne jemi këtu
15 vetëm në luftë, jemi vetëm me forcat policore, ushtarake,
16 paramilitare serbe e as sesi me civil. Kështu që edhe kjo iu
17 ka shërbyer ushtarëve të Brigadës 162 "Agim Bajrami" dhe nuk
18 kemi pas asnjë rast të tillë. Gjatë edukimit e kanë përdorur
19 këta tek ushtarët e rinj që asnjë, detyra jonë kryesore është
20 të luftojmë kundër forcave policore, ushtarake, paramilitare
21 serbe. Gjithherë u kam thënë që duhet të kemi kujdes që asnjë
22 civil nuk guxon me u dëmtu, pa marrë parasysh nacionalitetin.

23 PË. Në rregull. Hipotetike, supozojmë, supozojmë përveç
24 trajtimin që keni dhënë ju për të trajtuar siç duhet civilët,
25 supozojmë, e zëmë, e zëmë se ndodh diçka, çka kompetencash

1 kishe ti për të arrestuar apo për të mbajtur, ndaluar një
2 person se kryen një vepër penale apo një krim?
3 PË. Thjesht, ndoshta duket e pakuptueshme, por vërtetë nuk
4 jemi ballafaqu me këtë fenomen. Jemi kujdes, i kemi edukuar, i
5 kemi përgatitur ushtarët që mos edhe nuk e kemi pas asnjë
6 rast. Derisa nuk e kemi pas asnjë rast të tillë unë nuk kisha
7 mujt këtu me supozu se nganjëherë supozimet po merren kush
8 qysh po don me i marrë supozimet. Edhe nuk po merren drejt
9 edhe po merret supozimi dikush po don me e qit si fakt real që
10 nuk është fakt real. Kështu që kisha pas dëshirë që të folim
11 vetëm për raste konkrete.

12 PY. Në rregull. Faleminderit, Dëshmitar.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kaq pyetje
14 kisha unë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

16 [Mikrofoni çaktivizuar]

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

19 Z. Tully.

20 Z. TULLY: [Përkthim] Pesë minuta.

21 I lutem Sekretares së Gjykatës të vendosë në ekran faqen
22 036672. Ju kërkoj ndjesë se nuk e kam referencën në gjuhën
23 shqipe për momentin.

24 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Tully:

25 Z. TULLY: [Përkthim]

1 PY. Ka lidhje me organigramën që ju tregoi Gjykatësi Mettraux
2 tek pyetjet e veta, Dëshmitar, me atë grafikën. Ndërkohë që
3 presim që të shfaqet në ekran, ju thatë që nuk jeni ekspert
4 ushtarak, por unë do doja të dija si i krijuat ju këto
5 organigramë? Çfarë metodash përdorët për të krijuar këto
6 organigrama, këtë grafik?

7 PË. Këto i kam kriju pasi kam arrit më shumë se dhjetë vite
8 trajnim në Trupat Mbrojtëse të Kosovës me ushtritë e NATO-s.
9 Edhe i kam shfrytëzu këto njohuri që i kemi marrë nga forcat e
10 NATO-s gjatë dhjetëvjeçarit në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës
11 edhe i kam paraqit qysh është më së miri në libër.

12 PY. Me aq sa mundeshit, por çfarë dokumentesh, domethënë më
13 saktë, çfarë burimesh përdorët ju për ta krijuar këtë? Çfarë
14 dokumentesh përdorët si bazë?

15 PË. Nuk kam përdor ndonjë dokument konkret.

16 PY. Nuk përdorët ndonjë dokument arkive mbase?

17 PË. Nuk kam përdorur.

18 PY. Për mua është e qartë, është që pavarësisht çfarë keni
19 përdorur ju nuk keni përdorur asnjë citim se ku e keni bazuar
20 njohurinë tuaj apo ku e keni bazuar ju këtë organigramë. Nuk
21 kemi asnjë citim për këto, kështu apo jo që dhe të kemi
22 mundësi edhe ta verifikojmë?

23 PË. Nuk ka citim për shkak se, po e përsëris edhe një herë, e
24 kam, i kam rregullu këto duke shfrytëzu përvojën time në
25 Trupat Mbrojtëse të Kosovës gjatë dhjetë vjetëve që kam

1 punuar.

2 Z. TULLY: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës,
3 bëhet fjalë për dokumentin 672, 62.

4 PY. Që ta sqarojmë. Asnjë nga redaktorët tuaj, as doktor
5 Daci, z. profesor Daci dhe Shukri Buja nuk bënë komente për
6 këtë organigramë, kështu?

7 PË. Jo, nuk kanë bërë.

8 PY. Faleminderit. Shihni në ekran, në diagramin që ju tregoi
9 Gjykatësi Mettraux, ai ju bëri pyetje edhe për personat që
10 janë në këtë diagram. Dua të fukosohemi tek ky përshkrimi
11 "Mollopolc, janar-shkurt-qershor 1999".

12 S'e kemi dokumentin origjinal, çfarë keni përdorur ju për
13 të krijuar këtë, por ka një kapitull të tërë që i dedikohet
14 vdekjes së Qamil Ilazit në librin tuaj. Por Qamil Ilazi nuk ka
15 mundësi të ketë qenë komandant i brigadës në, shef i Brigadës
16 162 në qershor të '99, të paktën në qershor, sepse ai vdiq në
17 maj, kështu?

18 PË. E saktë. Nga 15 maji nuk ka qenë se ka ra në krye të
19 detyrës më 14 maj '99. Kjo ka qenë një supozim.

20 PY. Se ka një gabim shumë të madh në këtë organigramë, që s'e
21 ka parë asnjë prej redaktorët tuaj, recensuesit tuaj, askush
22 s'e ka vënë re domethënë, kështu?

23 PË. E vërtetë.

24 Z. TULLY: [Përkthim] Shkojmë tek faqja pararendëse që
25 mbaron me 71. Shkojmë pak më poshtë që ta shohim të plotë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hajrush Kurtaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 124

1 Pra, ky është një gabim që e keni thënë vetë në intervistë. Te
2 përshkrimi i Brigadës 162 keni harruar shefin e shtabit,
3 Xhemajl Krivanjeva. Kjo është në pjesën, keni lënë, nuk keni
4 përfshirë shefin e shtabit të një brigade të tërë në një
5 organigramë. Ju kujtohet kjo?

6 DËSHMITARI: Është e saktë, është një lëshim i imi dhe i
7 ekipit tim.

8 Z. TULLY: [Përkthim] Për përkthyesit emri, emri Xhemajl
9 Krivanjeva. Ju kërkojmë ndjesë për shqiptimin.

10 PY. Pra, u treguan dy organigrama ju që kanë dy gabime shumë
11 të mëdha. Kështu që ju nuk është se jeni, keni bërë analiza
12 shumë të thella kur keni përgatitur këtë organigramë apo jo?

13 PË. Është saktë.

14 PY. Faleminderit.

15 Z. TULLY: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
17 z. Tully.

18 Z. Ellis, keni pyetje?

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

21 Dëshmitar, me kaq përfundon dëshmia juaj për ditën e
22 sotme. Do t'ju shoqërojë tashmë Asistentja e Sallës.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë gjë
25 tjetër përpara se të përfundojmë për ditën e sotme?

1 Është pak vonë tani të fillojmë me dëshmitarin e ri.
2 Kështu që e mbyllim seancën për sot dhe shihemi ditën e hënë.
3 Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj.

4 Seanca mbyllet këtu.

5 --- Seanca mbyllet në orën 15.27

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25